



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 524 Akti

Nr. 595 Vendimi  
Tiranë, më 7.12.2022

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 1, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Lulzim Hamitaj</b>	Kryesues
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 2.12.2022, në orën 10:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish- Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Arbër Çela**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, i pranishëm në seancën dëgjimore.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH” dhe “E” të Aneksit të Kushtetutës;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Z. Arbër Çela është subjekt rivlerësimi për shkak të pozicionit të tij si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Bazuar në pikën 4 të nenit 4 dhe në pikën 2 të

nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim ka hedhur shortin në datën 15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1).

**2.** Në vijim të procesit të rivlerësimit, anëtarët deklaruan lidhur me konfliktin e interesit e, më tej, caktuan kryesues z. Lulzim Hamitaj. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë çështje është caktuar z. Gerrit Sprenger.

**3.** Gjatë procesit, subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues, i cili ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e trupit gjykues.

**4.** Relatori ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe nga Këshilli i Lartë Gjqësor.

**5.** Në bazë të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, gjatë procesit të rivlerësimit është komunikuar me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet adresës elektronike, si dhe janë mbledhur nga Komisioni informacione të nevojshme për hetimin sipas nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilave trupi gjykues ka vendosur mbi rezultatet e hetimit për subjektin rivlerësues.

**6.** Në datën 7.11.2022, trupi gjykues vendosi: (a) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit Arbër Çela, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit – vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (b) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, si dhe ta ftojë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (c) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.

**7.** Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin e konfirmoi edhe në seancën dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime dhe dokumentacion provues lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit, të cilat u administruan nga trupi gjykues për t’u vlerësuar në raport me vendimmarrjen përfundimtare.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**8.** Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit Arbër Çela në seancë dëgjimore, në datën 2.12.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 2.12.2022, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

**9.** Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe u mbrojti vetë. Ai paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit dhe barrën e provës, si dhe iu përgjigj pyetjeve të bëra gjatë seancës dëgjimore. Në përfundim të seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

**10.** Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për z. Arbër Çela në seancën e datës 7.12.2022, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte prezent gjithashtu.

### III. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI

11. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues; informacionin e përditësuar lidhur me subjektin e rivlerësimit nga institucionet ligjzbatuese;
- c) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me materialin shoqërues;
- ç) dokumentet shkresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik dhe dokumentacionin provues shoqërues;
- dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht dhe dokumentacionin provues shoqërues;
- e) denoncimet nga publiku dhe dokumentacionin për verifikimin e tyre, të mbledhur gjatë hetimit;
- ë) shpjegimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit të dhëna gjatë seancës dëgjimore.

12. Gjatë bisedimeve në dhomë këshillimi, trupi gjykues i Komisionit konstatoi se një çështje në rezultatet e hetimit lidhur me vlerësimin profesional kishte mbetur e patrajtuar/shpjeguar nga subjekti, prandaj vendosi të riçelë hetimin që t'i kërkojë këtë informacion subjektit të rivlerësimit. Në vijim, subjekti i rivlerësimit iu përgjigj komunikimit elektronik të Komisionit, duke dhënë shpjegimet e tij, material i cili u administrua në dosjen e rivlerësimit, për t'u vlerësuar në raport me vendimmarrjen përfundimtare.

#### A. VLERËSIMI I PASURISË

13. Në deklaratën e pasurisë *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë e vlerësuara sa vijon:

14. **Pasuria apartament me sipërfaqe 91.91 m<sup>2</sup>**, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, blerë me Kontratë Porosie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.5.2013, për çmimin 73.528 (shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e tetë) euro. Pjesa takuese: 50%, 36.764 (tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro, në bashkëpronësi me shtetasen E. Zh. (50% me 50%).

14.1 Burimi i krijimit i deklaruar në deklaratën *Vetting*: (i) Kontratë Kredie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro; (ii) dhurata nga prindërit në shumën 4.000 (katër mijë) euro; dhe (iii) kursimet personale.

14.1.1 Për aftësinë blerëse të bashkëpronares E. Zh., subjekti ka deklaruar dhe paraqitur: (i) vërtetimin datë 20.10.2016 dhe vërtetimin datë 25.1.2017 nga Zyra e Tregtisë Turke; (ii) vërtetimin datë 25.1.2017 nga GIZ-i; (iii) deklaratë noteriale huaje me znj. B. O. për shumën 8.000 (tetë mijë) euro.

14.2 Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në DPV-në e vitit 2013 me përshkrimin: “*Apartament me sipërfaqe 91.91 m<sup>2</sup>, në rrugën \*\*\*\*, në vlerën totale 73.528 (shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e tetë) euro, paguar 50% sipas pjesës, me burim krijimi kontratë kredie plus dhuratë nga prindërit*”.

14.3 Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasja E. Zh. kanë nënshkruar në datën 14.5.2013 Kontratën e Porosisë nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\*

kol., me palë sipërmarrëse shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për shitblerjen e pasurisë apartament me strukturë 2+1, në vlerën 73.528 (shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e tetë) euro, njëkohësisht pagesat për likuidimin e vlerës së kësaj pasurie janë kryer që në muajin maj të vitit 2013.

**14.4** Referuar dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>1</sup> evidentohet se ky apartament banimi është regjistruar në ZVRPP në datën 17.9.2013, në emër të shoqërisë ndërtuese. Në datën 20.6.2015 është realizuar kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit dhe shtetasja E. Zh. me shoqërinë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe është kryer regjistrimi i pasurisë sipas Certifikatës së Pronësisë datë 26.5.2015<sup>2</sup>, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe shtetasës E. Zh., secili me pjesë takuese 1/2.

**14.5** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë vendbanimi në DPV-në e vitit 2014 këtë apartament me përshkrimin “Rruga ‘\*\*\*\*’, pallati pas shkollës ‘\*\*\*\*’”. Në përgjigjet e pyetësorit standard<sup>3</sup> subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se jeton në këtë apartament me vendndodhje rruga “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*” sh.p.k., apartamenti nr. \*\*\*\*, kati \*\*\*\*, nga muaji prill i vitit 2015.

**14.5.1** Në lidhje me këtë mospërputhje subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e pyetësorit datë 31.5.2021<sup>4</sup>, ka shpjeguar si vijon: *“Fillimisht sqaroj se kur kam vendosur adresat në deklaratat e deklaramit periodik të pasurisë i jam referuar jo adresës ku kam banuar në vitin e deklaramit (që përgjithësisht i jam referuar vitit të kaluar kalendarik duke qenë se deklaratat i kam dorëzuar përgjithësisht në muajin mars të vitit pasardhës), por adresës aktuale të vendndodhjes në momentin e përpilimit të deklaratës (kjo për faktin se gjatë një viti deklarimi një subjekt mund të ndryshojë disa adresa banimi... Për shkak të zvarritjes së punimeve jemi futur në banesë vetëm diku nga muaji mars i vitit 2015, pra mbi 1 vit me vonesë”*.

**14.6** FSHU-ja informon<sup>5</sup> se në emër të subjektit të rivlerësimit është hapur kontratë shërbimi në datën 30.6.2015. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se në datën 2.6.2015 është përcjellë kërkesë nga OSHEE-ja për vendosjen e 257 matësve të kabinës “\*\*\*\*” sh.p.k. Nga *boxi* i pagesave evidentohet se faturimi ka nisur prej muajit qershor të vitit 2015 dhe se më parë nuk ka pasur faturim.

**14.7** UKT-ja informon<sup>6</sup> për një kontratë furnizimi në emër të subjektit të rivlerësimit me adresë rruga “\*\*\*\*” dhe nga dokumentacioni i disponuar rezulton lista e qytetarëve banorë në apartamentet e ndërtuara nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ku përfshihet edhe emri i subjektit, si dhe Kontrata e Porosisë datë 14.5.2013. Nga *boxi* i pagesave evidentohet se faturimi ka nisur prej muajit korrik të vitit 2015 e në vijim dhe më parë nuk ka pasur faturim.

## **Mbi marrëdhënien e bashkëpronësisë**

**14.8** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në përgjigjet e pyetësorit standard<sup>7</sup> raportin e tij me shtetasen E. Zh. dhe arsyen e investimit të përbashkët për krijimin e pasurisë apartament banimi në bashkëpronësi. Subjekti i rivlerësimit sqaron se me shtetasen E. Zh. janë kushërinj të dytë dhe në rrethanat që kjo shtetase nuk kishte banesë të sajën në Tiranë, por jetonte me qira, menduan që të blinin bashkërisht një banesë si formë investimi që të mos kishin shpenzime qiraje.

<sup>1</sup>Shihni shkresën nr.\*\*\* prot., datë 15.6.2022. Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka përcjellë dokumentacionin për këtë pasuri, konkretisht: Kontratën e Porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.5.2013; Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.6.2015; dhe konfirmimin nga “Tirana Bank”, datë 16.5.2013, mbi pagesën e kryer në datën 14.5.2013, nga z. Arbër Çela për llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., të shumës 57.250 (pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë) euro për blerje apartamenti.

<sup>2</sup>Shihni dokumentacionin e dorëzuar në ILDKPKI, lidhja 4/2.

<sup>3</sup>Shihni përgjigjet nr.1 të pyetësorit standard datë 31.8.2020.

<sup>4</sup>Shihni përgjigjet nr. 3 dhe 7 të pyetësorit datë 31.5.2021.

<sup>5</sup>Shihni shkresën nr.\*\*\* prot., datë 6.6.2022.

<sup>6</sup>Shihni shkresën nr.\*\*\* prot., datë 27.6.2022.

<sup>7</sup>Shihni përgjigjet nr. 14 dhe nr. 1 të pyetësorit standard datë 31.8.2020.

**14.8.1** Sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit jetesa me shtetasen E. Zh. në këtë apartament ka qenë për rreth një vit, secili me ekonomi më vete dhe se kanë kryer shpenzime mobilimi të apartamentit për periudhën 2014 – 2015, në shumën totale 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë, duke paguar secili gjysmën e shumës dhe pas lindjes së fëmijës dhe celebrimit më 1.4.2016 me bashkëshorten E. B. ka filluar bashkëjetesa dhe shtetasja E. Zh. është larguar nga banesa.

**14.9** Sipas certifikatës së Zyrës së Gjendjes Civile të Njësisë Bashkiake Nr. \*\*\* konfirmohet<sup>8</sup> se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasja E. B. janë celebruar në datën 1.4.2016 dhe janë prindërit e fëmijës A. Ç., lindur në datën 19.2.2016<sup>9</sup>. Sipas të dhënave, gjatë hetimit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë i fejuar me shtetasen E. B. që në vitin 2013.

**14.10** Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit mbi adresën e vendbanimit të shtetasës E. Zh. pas largimit nga apartamenti në bashkëpronësi dhe në përgjigjet e pyetësorit datë 31.5.2021<sup>10</sup> sqaron si vijon: *“Sqaroj se pavarësisht se apartamenti ynë ishte në bashkëpronësi, shtetasja E. Zh. vendosi që të largohej ajo nga banesa për shkakun se tashmë unë dhe bashkëshortja kishim një fëmijë të sapolindur. Në këto kushte, kjo shtetase vendosi të rikthehej në banesë me qira deri në pritje të zgjidhjes së çështjes së bashkëpronësisë së apartamentit”*.

Lidhur me pjesën takuese të shtetasës E. Zh. subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo shtetase në momentin e largimit rreth muajit mars të vitit 2016, ia ka lënë në përdorim pjesën e saj ideale subjektit pa qira.

**14.11** Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e ka përdorur këtë pasuri (pjesën takuese të znj. E. Zh.) pa kundërshpërblim, deri në vitin 2018, kur prindërit e tij kanë blerë pjesën takuese të bashkëpronares kundrejt vlerës 40.000 (dyzet mijë) euro<sup>11</sup>.

**14.12** “Tirana Bank”<sup>12</sup> ka përcjellë për Komisionin: (a) mandatpagesën datë 14.5.2013, për shumën 57.250 (pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë) euro, derdhur *cash* nga subjekti i rivlerësimit për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin: “Blerje apartamenti Kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.5.2013, me burim kursime + huamarrje”; (b) mandatpagesën datë 15.5.2013, për shumën 16.278 (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë) euro, derdhur *cash* nga shtetasja E. Zh. për shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. me përshkrimin “Likuidim total apartamenti me burim të ardhurat kursime + huamarrje”.

Sipas mandateve bankare rezulton se investimi i subjektit (shuma faktike e paguar) është në vlerën 57.250 (pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë) euro (77% e vlerës së pasurisë) dhe investimi i shtetasës E. Zh. në shumën 16.278 (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë) euro, derdhur *cash* prej saj.

**14.13** Nga gjendja faktike vërehet se:

a) Sipas kontratës së premtim-shitjes dhe kontratës së shitjes përfundimtare nuk ka pasur parashikime për pjesën takuese apo kontributin e secilit prej bashkëpronarëve dhe në certifikatën e pronësisë është përcaktuar ½ pjesë. Sipas nenit 199 të Kodit Civil parashikohet se pjesa e bashkëpronësisë është e barabartë derisa të vërtetohet e kundërta.

b) Transferta bankare në bazë të së cilës subjekti i rivlerësimit ka depozituar një shumë prej 57.250 (pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë) euro në favor të shoqërisë,

<sup>8</sup>Shihni certifikatë martesë datë 23.1.2017, lidhja 4/1 tek dokumentet e ILDKPKI-së.

<sup>9</sup>Shihni certifikatën e lindjes datë 23.1.2017 lidhja 4/1 tek dokumentet e ILDKPKI-së.

<sup>10</sup>Shihni përgjigjen nr. 6 të pyetësorit datë 31.5.2021.

<sup>11</sup>Sipas dokumentacionit nga ASHK-ja në datën 17.10.2018, pjesa takuese e shtetasës E. Zh. është tjetërsuar në emër të shtetasit I. Ç. (babai i subjektit të rivlerësimit).

<sup>12</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2022 dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2022.

përbën një provë se investimi në apartament nuk është në përpjesëtim me pjesën e tij të pronësisë.

c) Në përshkrimin e bërë për transfertën bankare të shumës 57.250 (pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e pesëdhjetë) euro, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar se një pjesë e vlerës e derdhur *cash* është nga shtetasja E. Zh. apo specifikuar burime të palëve të tjera të përfshira në shumë (deklaruar “kursime + huamarrje”).

ç) Në bazë të akteve në dosje: (i) kontratat e shërbimeve utilitare janë lidhur në emër të subjektit të rivlerësimit; (ii) faturimi i furnizimit me energji elektrike ka filluar në qershor të vitit 2015, ndërsa faturimi i furnizimit me ujë ka filluar në korrik të vitit 2015, që tregon se apartamenti ka qenë në përdorim afërsisht 9 muaj para se të lindte vajza e subjektit të rivlerësimit (shkurt 2016).

d) Blerja e apartamentit nga babai i subjektit të rivlerësimit duket se mbështet dyshimet se apartamenti ka qenë fillimisht në pronësi të subjektit të rivlerësimit, pasi ai vazhdon të jetojë në Lushnjë dhe statusi i tij si person fizik rezulton aktiv për ushtrimin e aktivitetit të tij privat në këtë qytet edhe aktualisht.

**14.14** Duke marrë parasysh sa më sipër, si dhe jurisprudencën<sup>13</sup> e Kolegjit, Komisioni ka vlerësuar që çështja të shihet edhe në vlerësimin e mundësive financiare të znj. E. Zh., në përputhje me nenin 3 (14) të ligjit nr. 84/2016.

### **Analiza financiare për krijimin e pasurisë**

#### **• Lidhur me mundësinë financiare të bashkëpronares E. Zh.**

**14.15** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se kontributi i znj. E. Zh. është 50% [34.764 (tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro] me burim nga të ardhurat e saj (vërtetime page<sup>14</sup>) dhe një hua (deklaratë<sup>15</sup> noteriale huaje).

**14.16** Në procesverbalin e mbajtur në datën 20.10.2014 pranë ILDKPKI-së<sup>16</sup> subjekti i rivlerësimit është pyetur lidhur me aftësitë financiare të bashkëpronares, duke vendosur në dispozicion vërtetimet e pagës të datave 6.11.2014 dhe 4.12.2014, të bashkëpronares E. Zh., lëshuar nga Ambasada Turke, ku konfirmohet se shtetasja E. Zh. është në marrëdhënie pune prej gushtit të vitit 2009.

**14.17** Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit mbi të ardhurat dhe mundësitë financiare të shtetasës E. Zh. për krijimin e pasurisë. Në përgjigjet e pyetësorit datë 31.5.2021<sup>17</sup>, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në kuptim të ligjit nr. 84/2016 kjo shtetase nuk mund të konsiderohet si person tjetër i lidhur, duke referuar raste nga praktika e ndjekur nga Kolegji, vendimin nr. 15, datë 17.7.2019, etj.

**14.18** Lidhur me marrëdhënien me shtetasen E. Zh., subjekti i rivlerësimit shpjegon se: *“Në këto kushte sqaroj se me shtetasen E. Zh. nuk kam pasur në asnjë rast situatë huaje apo dhurimi. Marrëdhënia në këtë rast lidhet vetëm me faktin e një bashkëpronësie në një apartament, ku kjo shtetase ka jetuar aty si bashkëpronare në 50% të tij dhe, po ashtu, unë kam jetuar aty duke shfrytëzuar pjesën time të pronës. Për më tepër, sjell në vëmendje faktin se jo në pak raste në marrëdhëniet juridiko-civile përdoret si formë e pronësisë shumëpronësia (një formë kjo e bashkëpronësisë). Si rrjedhojë e kësaj kam*

<sup>13</sup>Organi gjyqësor, në analizën që i bën gjendjes faktike në lidhje me kualifikimin ligjor të statusit të bashkinvestitorit në një pasuri të përbashkët, për llogari të procesit të rivlerësimit, mban në konsideratë trajtimin ligjor të kryer nga Kolegji në rastet e mëparshme, sipas të cilave, kur nga hetimi administrativ nuk ka asnjë konstatim mbi bazën e të cilit mund të ngriheshin dyshime të arsyeshme në lidhje me përfshirjen reale të këtyre personave në investim, pra dyshime për fshehje nga subjekti i rivlerësimit të pasurisë së tij për llogari të këtyre bashkinvestitorëve, cilësimi si persona të tjerë të lidhur të bashkinvestitorëve nuk bazohet në ligj, për aq kohë sa vlera e investimit të subjektit në ndërtimin e godinës, sipas deklaratës së tij *Vetting* dhe në deklaratat e interesave privatë periodikë; (i) është në përpjesëtim me pjesën e tij takuese të pronësisë dhe afër vlerave të deklaruara të investimit si bashkëpronarët e tjerë; (ii) dhe në vendimin e Komisionit nuk ka asnjë konstatim për të që të krijonte dyshime për fshehje nga ana e subjektit të pasurisë në emër të bashkinvestitorëve; (iii) secili nga bashkëpronarët ka investuar dhe gëzon në përputhje me investimin pjesët e tatueshme të tij, pa i kaluar asnjë të drejtë subjektit të rivlerësimit, organi gjyqësor vlerëson se situata faktike nuk mund të cilësohet si ajo e parashikuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe se shtetasit F. B., K. B. dhe Sh. M. nuk konsiderohen si persona të tjerë të lidhur, për të cilët lind detyrimi për justifikimin e burimeve ligjore.

<sup>14</sup>Vërtetim të datës 20.10.2016 nga Ambasada Turke në Tiranë ku konfirmohet se shtetasja E. Zh. është e punësuar si specialiste administrate prej Gushtit 2009 deri në Dhjetor 2014. Sipas këtij vërtetimi kjo shtetase për periudhën 31.08.2009 - 01.05.2013 ka realizuar të ardhura neto nga paga në shumën totale 28.750 euro.

<sup>15</sup>Deklarata noteriale nr.\*\*\* prot., nr.125 kol., datë 25.01.2017 me palë deklarues shtetasen E. Zh. dhe B. O. ku konfirmohet se shtetasja B. O. i ka dhënë shtetasës E. Zh. në maj të vitit 2013 hua në shumën 8.000 euro pa interes dhe afat.

<sup>16</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2022.

<sup>17</sup>Shihni përgjigjen nr. 6 të pyetësorit datë 31.5.2021.

*qëndrimin se bashkëpronari nuk mund të konsiderohet si 'person tjetër i lidhur' në kuptim të ligjit nr. 84/2016 'Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë' vetëm për faktin e ekzistencës së kësaj marrëdhënieje, për sa kohë që midis tyre nuk ka një marrëdhënie huaje apo dhurimi”.*

**14.19** Në bazë të të dhënave bankare shuma 10.285 (dhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) euro është tërhequr në datën 15.5.2013 nga llogaria e znj. E. Zh. pranë BKT-së. Origjina e kësaj shume ka ardhur nga disa depozita në gjendje *cash* në periudhën 4.9.2012 - 15.5.2013, ku përfshirë edhe interesin e përfituar shkon në shumën 6.284,91 (gjashtë mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër e nëntëdhjetë e një cent) euro, ndërsa diferenca 4.004,99 (katër mijë e katër e nëntëdhjetë e nëntë cent) euro ka ardhur nga pagat e patërhequra.

**14.20** Sipas të dhënave nga ISSH-ja<sup>18</sup>, rezulton se shtetasja E. Zh. është e punësuar pranë Këshillit të Tregtisë së Jashtme pranë Ambasadës Turke me pagë *bruto* mujore prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekësh dhe pagë *neto* mujore prej 20.275 (njëzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lekësh për periudhën janar 2012 - prill 2013 dhe në muajin maj 2013 është deklaruar pagë *bruto* mujore prej 30.000 (tridhjetë mijë) lekësh dhe pagë *neto* mujore prej 26.130 (njëzet e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë) lekësh.

**14.21** Komisioni ka kërkuar informacion nga arkivi Lundër për të dhënat para vitit 2012 (2009 – 2012). Nga të dhënat ka rezultuar se shtetasja E. Zh. për periudhën 2009 – 2012, është siguruar me pagë 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë *bruto*.

**14.22** Në lidhje me dy kontratat e huas në shumat 8.000 (tetë mijë) euro dhe 10.000 (dhjetë mijë) euro, të marra hua nga shtetasja E. Zh., konstatohet se Deklaratat Noteriale<sup>19</sup> janë të viteve, përkatësisht 2017 dhe 2019.

**14.23** Huaja e pretenduar në deklaratën *Vetting*, e dokumentuar me deklaratën e datës 25.1.2017, nuk është deklaruar në procesverbalet e ILDKPKI-së, të mbajtur në vitin 2014, kur është thirrur dhe pyetur për aftësinë blerëse të bashkëpronares, por në një qasje pozitive, kjo huadhënie afrohet me pagesën e kryer prej saj në datën 15.5.2013 tek shoqëria e ndërtimit në shumën 16.278 (gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë) euro.

**14.24** Në përfundim rezulton se edhe nëse ndiqet një qasje e favorshme, personit tjetër të lidhur zonjës E. Zh. i mungojnë burimet e ligjshme për të mbuluar pjesën takuese të pretenduar 50% të apartamentit.

• ***Lidhur me mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit Arbër Çela***

i. *Kontratë Kredie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro, deklaruar burim për blerjen e pasurisë*

**14.25** Gjatë pyetësorëve<sup>20</sup> subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: “*Vlerësoj të sqaroj se në momentin kur kam kryer aplikimin në bankë për marrje kredie, i kam paraqitur si kërkesë bankës financimin e borxhit që kam marrë tek shtetasi F. H. për blerjen e pjesës sime të apartamentit. Kredia nga ana e 'Tirana Bank' është disbursuar në datën 27.9.2013 dhe shuma prej 30.000 euro ka kaluar direkt në llogarinë bankare të shtetasit F. H. me shënimin 'kthim huaje në datën 30.9.2013'.* Subjekti i ka bashkëlidhur: (i) kërkesë dërguar “Tirana Bank” për aplikim për kredi në datën 25.6.2013 nga subjekti i rivlerësimit, në të cilën citohet si vijon: “*Kam blerë një apartament në rrugën '\*\*\*', Tiranë, me sipërfaqe 91.91 m<sup>2</sup>, kosto totale 73.528 (shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e tetë) euro. Nga këto kam paguar të gjitha këstet sipas kontratës së porosisë me shoqërinë '\*\*\*' sh.p.k. me para të marra hua sipas kontratës së huas me z. F. H., në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro*”; (ii) propozimin e kredisë së kryer nga drejtori i degës së Lushnjës, datë 1.7.2013, ku citohet se subjekti i rivlerësimit ka likuiduar totalisht çmimin e pasurisë apartament në shumën

<sup>18</sup>Shihni dosjen e ILDKPKI-se, seksioni 34.

<sup>19</sup>Në praktikat e konsoliduara tanimë të Kolegjit është vlerësuar gjithashtu në lidhje me vlerën provuese dhe rezervën në lidhje me deklaratat noteriale të lëshuara për qëllime të procesit të rivlerësimit, konkretisht, vendimi nr. 36/2020 (JR), paragrafi 16.6; vendimi nr. 33/2020 (JR), paragrafi 20.5; vendimi nr. 29/2020 (JR), paragrafi 32.5, etj.

<sup>20</sup>Shihni përgjigjen nr. 2 të pyetësorit datë 7.7.2022.

73.528 (shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e tetë) euro dhe se 30.000 (tridhjetë mijë) euro i ka marrë hua sipas një deklarate noteriale dhe se kredia duhet të disbursohet në llogarinë e huadhënësit F. H.

**14.26** Nga verifikimi i dokumentacionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer aplikim për kredi individuale në “Tirana Bank”<sup>21</sup>, dega Lushnjë, deklaruar objekti “Me qëllim blerjeje apartamenti në shumën 30.000 euro” (nuk ka të dhëna për datën e aplikimit).

**14.27** Referuar setit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga “Tirana Bank”<sup>22</sup>, dega Lushnjë, rezulton se në datën 11.9.2013 është nënshkruar kontrata e kredisë bankare hipotekore me objekt kredie për blerje shtëpie midis palës kredidhënëse “Tirana Bank” dhe palës kredimarrëse subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e tij, në cilësinë e dorëzanësit.

**14.28** Nga hetimi i llogarisë bankare në monedhën euro të subjektit të rivlerësimit në “Tirana Bank”, ka rezultuar se në datën 27.9.2013 është disbursuar kredia në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro në llogarinë e subjektit dhe në datën 30.9.2013, subjekti i rivlerësimit e ka transferuar këtë shumë në llogarinë në euro të shtetasit F. H. në “Tirana Bank”, me përshkrimin “kthim borxhi”.

**14.29** Nga hetimi i llogarisë bankare në euro të shtetasit F. H. ka rezultuar se kjo llogari është hapur në datën 30.9.2013 dhe se në të njëjtën ditë shuma prej 30.000 (tridhjetë mijë) euro është tërhequr *cash* nga ky shtetas.

*ii. Hua nga shtetasi F. H. në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) euro/burim për krijimin e pasurisë*

**14.30** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë gjatë hetimit administrativ se burim për pagesën e pjesës së tij takuese të pasurisë apartament ka shërbyer huaja në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro, e marrë në maj të vitit 2013 nga shtetasi F. H., duke bashkëlidhur Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.6.2013, me përshkrimin “kontratë huaje lekësh”, si dhe dokumentacionin për burimin e të ardhurave të shtetasit F. H. – kopje të ekstraktit të QKB-së për ushtrimin e aktivitetit si person fizik “F. H.”.

**14.31** Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që shtetasi F. H. të mos konsiderohet si person tjetër i lidhur, duke shpjeguar si vijon: *“Vlerësoj të sqaroj se shtetasi F. H. nuk mund të konsiderohet person tjetër i lidhur me mua në kuptim të ligjit nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, për shkak se nuk ndodhem në marrëdhënie interesi me të, thjesht marrja e huas nga ana ime për disa muaj deri në marrjen e kredisë nuk më bën person tjetër të lidhur me të”.*

**14.32** Bazuar në Udhëzimin nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj.”, nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se: *“6. Persona të tjerë të lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, janë personat fizikë dhe juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, ... që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.*

*Kur subjekti i rivlerësimit deklaron këto lloj marrëdhëniesh juridike me persona të tjerë të lidhur, ai mbart detyrimin të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor në*

<sup>21</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.7.2022.

<sup>22</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.6.2022.



momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë për pronësinë dhe burimin e krijimit të pronës, që bëhet objekt i kësaj marrëdhënieje me subjektin e rivlerësimit.

7. Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të deklarojë burimin në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre”.

**14.33** Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së për procesin e rivlerësimit kalimtar, dorëzuar së bashku me deklaratën *Vetting*, nuk rezulton kjo kontratë huaje, as deklaruar marrëdhënia e huas apo borxhit mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit F. H., po ashtu ajo nuk rezulton as e analizuar gjatë verifikimeve të kryera nga ILDKPKI-ja në kuadër të këtij procesi.

**14.34** Duke marrë parasysh marrëdhëniet ndërmjet shtetasit F. H. dhe subjektit të rivlerësimit, konkretisht:

i) Kontratë Huaje, datë 14.6.2013, në bazë të së cilës shtetasi F. H. ka deklaruar se ka në pronësi shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro dhe ia jep shumën shtetasit Arbër Çela me një afat tremujor për nevoja familjare. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka marrë shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro, të cilën do ta shlyejë me disbursimin e kredisë nga “Tirana Bank”.

ii) Deklaratë Noteriale, datë 23.10.2013, ku shtetasi F. H. deklaroi se lidhur me huan e dhënë shtetasit Arbër Çela në maj të vitit 2013, në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro për blerje apartamenti, kryer pranë noterit me akt noterial datë 14.6.2013, ku ishte përcaktuar afati tremujor për shlyerjen, është likuiduar plotësisht dhe nuk ka asnjë pretendim për huan apo kamatëvonesë (kjo kontratë nuk figuron e deklaruar në regjistrin noterial).

iii) Nxjerrje llogarie në “Tirana Bank”, ku rezultoi se kredia është disbursuar në datën 27.9.2013 në llogari të subjektit të rivlerësimit, në datën 30.9.2013 është kryer një transfertë bankare nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në llogarinë e shtetasit F. H., në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro, me përshkrimin “kthim borxhi”. Shtetasi F. H. e ka tërhequr shumën në të njëjtën datë.

**14.34.1** Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si burim këtë huadhënie në deklaratën *Vetting*, sipas udhëzimit nr. \*\*\*, datë 10.10.2016, të inspektorit të ILDKPKI-së, pika 7 e ligjit nr. 9049/2003 (i ndryshuar).

**14.35** Duke marrë parasysh se gjatë hetimit kanë rezultuar gjurmë të kësaj marrëdhënieje, si dhe kjo shumë ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë në momentin e krijimit të saj, Komisioni vlerësoi se duhet bërë analizë e burimeve të shtetasit F. H. dhe mundësinë e tij për këtë huadhënie, e cila rezultoi sa më vijon:

i) Shtetasi F. H. ishte i regjistruar si biznes që në vitin 2000 për “prodhim materialesh ndërtimi”.

ii) DRT-ja dhe burime të tjera të hapura informacioni (QKB) japin të dhënat e mëposhtme të kësaj të fundit si vijon:

Monedha lekë	Qarkullimi i realizuar DRT	Fitim/Humbje DRT	Fitim/Humbje sipas pasqyrave financiare duke filluar nga viti 2010	Fitimet e pashpërndara + rezervat + fitimi/humbja neto e vitit aktual sipas pasqyrave financiare, duke filluar nga viti 2010	Likuiditetet Monetare (arka+banka) në fund të vitit	Gjendja e inventarit (lëndë e parë + produkt i gatshëm) në fund të vitit
Viti ushtrimor						
2008	4.250.000	+302.100	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
2009	2.997.510	+312.000	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
2010	25.362.708	+2.184.059	+1.868.499	2.037.695	183.114	4.143.982
2011	6.602.675	+1.722.378	+1.499.732	3.487.427	81.160	6.201.677
2012	2.930.140	+146.287	+130.641	3.618.068	46.888	6.328.899
2013	154.258	-418.045	-559.247	3.058.821	36.773	6.754.114
2014	2.119.982	-61.741	-62.326	2.996.495	88.574	6.587.746

iii) Nga analiza e pasqyrës financiare të personit fizik “\*\*\*\*”, duket se fitimi është akumuluar në fitimin e pashpërndarë si pjesë e kapitalit *neto* që nga viti 2010 dhe, për rrjedhojë, nuk ka pasur shuma të disponueshme për pronarin. Shuma e akumuluar nuk është *cash*, por reflektohet në rritje të stokut/inventarit të biznesit.

iv) Sipas Kontratës së Premtim-Shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.1.2013, shtetasi F. H. rezulton si palë premtim shitje lidhur me shitjen e dy pasurive në pronësi të tij, truallit me sipërfaqe 3.750 m<sup>2</sup> dhe 60 m<sup>2</sup> ndërtesë dhe truall me sipërfaqe 1.900 m<sup>2</sup>. Në këto pasuri ndodhet aktiviteti i biznesit të shtetasit F. H. dhe në këtë pronë është vendosur një stok me materiale (qymyr, gëlqere, zhavorr etj.).

Në kontratë parashikohet që stoku do të transferohet në datën e lidhjes së kontratës në posedim të palës blerëse dhe kjo e fundit të merrte përsipër shitjen e materialit të palës e treta.

Çmimi i pasurive do të jetë 100.000 (njëqind mijë) euro. Pala e premtimit për blerje deklaronte se një shumë prej 4.500.00 lekësh i është parapaguar *cash* shtetasit F. H. jashtë zyrës noteriale. Me shitjen e të gjitha materialeve të stokut, palët nënshkruajnë kontratën përfundimtare të shitjes së pasurisë së paluajtshme.

✓ Nga verifikimet e Komisionit kjo kontratë nuk rezulton e deklaruar<sup>23</sup> në regjistrin noterial; Kjo kontratë nuk rezulton e deklaruar në DPPP nga noteri. Nga verifikimet të noteri, si dhe regjistri noterial gjithashtu nuk rezultojnë kontrata të tjera të mëvonshme apo akte përfundimtare mes palëve.

v) Për një analizë të plotë mbi mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, Komisioni, në përpunje me proporcionalitetin e hetimit të burimeve të personave të tjerë të lidhur, ka kërkuar në DRT-të Berat dhe Tiranë informacion mbi librat e shitjes dhe blerjes së personit fizik “\*\*\*\*”, për të verifikuar nëse është lëshuar një faturë për transaksionin e shitjes së mallit/inventar.

✓ Nga DRT-ja Berat nuk rezultojnë të dhëna lidhur me këtë kontratë në pasqyrat financiare të vitit 2013, pasqyrat e fluksit monetar, ashtu edhe në librat e shitjes të depozituara nga ky subjekt në sistemin informatik tatimor.

✓ Në bazë të analizës së pasqyrave financiare të llogarisë së inventarit në bilancin e shoqërisë<sup>24</sup>, vihet re mes bilancit të viteve 2012 dhe 2013 një diferencë prej 425.215 (katërqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë) lekësh dhe duket se malli në inventar nuk është shitur brenda vitit 2013. Nga verifikimi i bilancit të vitit 2013 nuk rezultojnë shitje në vlerën e kontratës apo parapagime të kryera në këtë vlerë gjatë vitit ushtrimor (material i marrë nga QKB-ja *online*).

Mbetet e paqartë nëse janë përmbushur kushtet e përcaktuara në kontratë, si dhe mbetet e paprovuar ekzistenca e shumës së pretenduar (marrë paradhënie) dhe përdorimi i saj si burim për huadhënien.

vi) Janë kërkuar llogaritë bankare të shtetasit F. H. si individ dhe si person fizik (subjekt tregtar) nëse ka ndonjë gjurmë transaksioni në lidhje me kontratën e sipërpërmendur:

✓ Nga 16 institucione bankare, shtetasi F. H. ka rezultuar me llogari aktive në vitet 2004 – 2013 e në vijim në “Raiffeisen Bank”, nga ku rezulton me llogari personale/rrjedhëse/depozita, llogari bono thesari, llogari *cash cover*. Llogaria personale rezulton me gjendje likuiditete të bollshme, si dhe veprime tërheqjeje, transferime. Po ashtu, rezultojnë edhe llogari rrjedhëse në emër të biznesit, të cilat kanë kryesisht pagesa detyrime/tatime/etj. apo të hyra nga fatura apo derdhje *cash*

<sup>23</sup>Regjistri noterial duket se ka filluar në mars të vitit 2013.

<sup>24</sup>Shkarkuar nga QKB-ja.

nga shtetasi F. H.. Ai rezulton aktiv si individ, por edhe si person fizik edhe në “Alpha Bank” dhe në “ProCredit Bank”.

- ✓ Nga llogaritë bankare të administruara nuk vërehen gjurmë transaksioni në lidhje me Kontratën e Premtim-Shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.1.2013, mes shtetasve F. H. dhe A. H.

**14.36** Nga verifikimi i veprimtarisë tregtare të shtetasit F. H. rezulton se ai ka pasur aktivitet dhe qarkullim. Nga të dhënat e bilancit nuk kanë rezultuar likuiditete në arkën e shoqërisë ekuivalente me shumën e huadhënies.

**14.37** Nga hetimi administrativ ka rezultuar se prindërit e subjektit të rivlerësimit dispononin gjendje likuiditetesh në llogaritë e tyre bankare (përgjatë të gjithë periudhës së huas së pretenduar, gjendje në llogari në vitet 2012 – 2014). Lidhur me këtë konstatim gjatë hetimeve, subjekti ka shpjeguar se nuk ka dashur të prishë depozitat bankare të prindërve të tij (depozitat ishin me afat tremujor).

**14.38** Në analizë të sa më sipër, si dhe kërkesës së subjektit të rivlerësimit, Komisioni paraprakisht vlerëson se, bazuar në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me dorëzimin e deklaratës *Vetting* subjekti ka pasur detyrimin që të deklarojë dhe të paraqesë të gjitha dokumentet që justifikojnë ligjshmërinë e burimit në kohën e krijimit të pasurive. Nga verifikimi i kryer nga Komisioni lidhur me mundësitë financiare të huadhënësit rezulton se burimi i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si e ardhur e disponuar prej tij për kryerjen e pagesës për apartamentin, mbetet i paprovuar, pasi nuk rezultojnë të ardhura nga biznesi dhe as të ardhurat e pretenduara nga Kontrata e vitit 2013 për shtetasin F. H. Ky burim për krijimin e pasurisë (marrëdhënia e huas) rezulton i padeklaruar në deklaratën *Vetting*.

*iii. Dhuratë nga prindërit në shumën 4.000 (katër mijë) euro*

**14.39** Me plotësimin e deklaratës *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka paraqitur Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.10.2014, të shtetasit I. Ç., i cili ka deklaruar se në muajin prill të vitit 2013 i ka dhuruar subjektit të rivlerësimit një shumë të hollash prej 4.000 (katër mijë) euro, mbi të cilën nuk ka asnjë pretendim.

**14.40** Nga verifikimi i dokumentacionit (likuiditetet bankare, të ardhurat nga paga e prindërve dhe kontrata të ndryshme) rezulton se ata kanë pasur mundësi financiare me burime nga pagat për të kursyer shumën prej 4.000 (katër mijë) euro, të cilën e deklarojnë të dhuruar subjektit të rivlerësimit.

*iv. Kursimet personale në shumën 2.764 (dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro [kontributi 36.764 (tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro sipas pjesës 50%]*

**14.41** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* kursimet personale, si burim për krijimin e kësaj pasurie.

**14.42** Sipas deklarimeve të gjendjes *cash* në DPV-të vjetore për periudhën 2010 – 2012 duket se gjendja *cash* e deklaruar në fund të vitit 2012 është në shumën 960.000 (nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Sipas DPV-së vitit 2013, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi ndryshime të gjendjes *cash*.

**14.43** Komisioni ka përgatitur analizën financiare për mundësinë e likuiditeteve të përdorura nga subjekti i rivlerësimit në shumën 387.540 (treqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e dyzet) lekë [2.764 (dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro] nga ku rezulton se nga përdorimi i gjendjes *cash* në banesë të krijuar deri në vitin 2012 [e deklaruar në shumën totale 960.000 (nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë] ai mund të ketë likuiduar shumën e deklaruar.

Referuar të ardhurave përgjatë vitit 2013 ai rezulton në pamundësi financiare në fund të vitit për të ruajtur të njëjtën gjendje *cash* të deklaruar [duke rezultuar me minus në analizën financiare të vitit 2013 për krijimin e gjendjes *cash* në shumën -225.656 (dyqind e njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë] trajtuar në analizën financiare të subjektit.

v. *Kursimet personale në shumën 23.250 (njëzet e tre mijë e dyqind e pesëdhjetë) euro (llogaritur sipas investimit)*

**14.44** Komisioni ka përgatitur analizën financiare për mundësinë e likuiditeteve të përdorura nga subjekti i rivlerësimit në shumën 3.259.878 (tre milionë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë [23.250 (njëzet e tre mijë e dyqind e pesëdhjetë) euro], nga ku subjekti rezulton në pamundësi financiare për kryerjen e kësaj pagese në datën 14.5.2013, në masën -3.097.994 (tre milionë e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë.

**14.45** Nga dokumentacioni bankar ka rezultuar se shtetasja E. Zh. dhe vëllai i saj kanë derdhur në bankë në llogarinë e kredisë së subjektit të rivlerësimit disa këste mujore për periudhën 2013 – 2018 [rreth 26 këste mujore në shumën totale 6.700 (gjashtë mijë e shtatëqind) euro].

**14.46** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ASHK-ja<sup>25</sup> rezulton se nëpërmjet Kontratës së Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.10.2018, shtetasi I. Ç. ka blerë pjesën ideale të bashkëpronësisë së shtetasës E. Zh. në pasurinë apartament banimi kundrejt vlerës 40.000 (dyzet mijë) euro. Sipas kartelës së pasurisë figuron se kjo pasuri është regjistruar në datën 17.10.2018, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe babait të tij I. Ç., me pjesë takuese 1/2 secili.

**14.47** Nga të dhënat ka rezultuar se znj. E. Zh. ka blerë në vitin 2022 pasurinë apartament me sipërfaqe 97.2 m<sup>2</sup>, ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në Tiranë (Rruga \*\*\*), me vlerë 123.000 (njëqind e njëzet e tre mijë) euro, shtetasve K. Zh. dhe H. Sh. UKT-ja ka vënë në dispozicion edhe kontratën përkatëse.

**14.48** Nga verifikimi i të dhënave bankare ka rezultuar një pagesë pjesërisht për këtë pasuri në shumën 83.000 (tetëdhjetë e tre mijë) euro, kryer nga llogaria personale e shtetasës E. Zh. në llogarinë e noterit nëpërmjet transfertës bankare. Në këtë shumë të paguar përfshihet edhe vlera prej 40.000 (dyzet mijë) euro, e përfituar nga shitja e pjesës takuese e shtëpisë në bashkëpronësi me subjektin e rivlerësimit.

**14.49** Në përfundim në lidhje me këtë pasuri Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar:

- Se kontributi ka qenë në shumën 36.764 euro, ndryshe nga sa ka rezultuar nga gjëndja faktike gjatë hetimit administrativ nga ku konstatohet se kontributi i tij ka qenë në shumën 57.250 euro.
- Se nuk është deklaruar burimi konkret i të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie në raport me kërkesat e nenit 32 të ligjit nr.84/2016 dhe Udhëzimit Nr. 4095 Prot., datë 10.10.2016, duke ndryshuar burimin gjatë hetimit administrativ.
- Se nuk gjendet në kushtet e nenit D pika 5 të Aneksit të Kushtetutës duke provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm burimet financiare të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie duke përfshirë edhe pjesën e shtetasës E.Zh.
- Vërtetësinë e deklarimeve në deklaratën veting si dhe burimin e ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie. Deri sa të provohet e kundërtën sa më sipër subjekti rezulton në pamundësi financiare në shumën prej -7.304.299 lekë për krijimin e kësaj pasurie.

<sup>25</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2020.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**14.50** Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur parashtrimet e tij lidhur me marrëdhënien e bashkëpronësisë dhe pjesës së tij takuese, duke i qëndruar thëniet të bëra gjatë hetimit administrativ. Ai ka paraqitur parashtrimet e tij lidhur me burimin e të ardhurave për pjesën e bashkëpronares, shtetas E. Zh.:

*“Sqaroj se si përpara ILDKPKI-së, ashtu edhe në deklaratën Vetting, jam përqendruar duke saktësuar dhe sjellë dokumentacion të plotë provues për pjesën time të investimit. Duke qenë se shtetasja E. Zh. nuk konsiderohej dhe as konsiderohet për shkak të ligjit person i lidhur apo person tjetër i lidhur me mua, si dhe referuar faktit që ajo nuk ka qenë dhe nuk është subjekt deklarimi si për sa u përket shpjegimeve ashtu edhe sa i përket burimit të investimit të pjesës së saj ju jam referuar atyre të dhënave, shpjegimeve dhe dokumenteve që më janë vënë në dispozicion prej saj dhe meqenëse nuk më është kërkuar dokumentacion shtesë nuk kam qenë ezaurues në depozitim të tij.*

*Në momentin që jam pyetur nga ana juaj nëpërmjet pyetësorit mbi të ardhurat dhe mundësitë financiare të shtetas E. Zh. për krijimin e pasurisë, atëherë kam paraqitur edhe dokumentacionin e plotë në lidhje me këtë fakt. Si rrjedhojë, konstatimet tuaja se huat nuk janë deklaruar kurrë pranë ILDKPKI-së, si burim i të ardhurave për pjesën takuese të bashkëpronares, gjatë hetimit të kryer në vitin 2014 – subjekti i rivlerësimit paraqet burime të reja gjatë hetimit administrativ, të cilat nuk janë deklaruar më parë – nuk qëndrojnë dhe këto rrethana nuk mund të vlerësohen thjesht në nivel deklarativ.*

*Në kushtet kur kjo shtetase nuk është subjekt deklarimi dhe as rivlerësimi, nuk është person i lidhur apo tjetër i lidhur me mua në kuptim të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, provon marrëdhënien e punësimit dhe të ardhurat e përfituara prej saj janë të ligjshme, kërkoj që nga ana juaj të konsiderohen si të ardhura me burime të ligjshme, të ardhurat e saj për periudhën 2009 – 2013, në shumën totale prej 28.750 (njëzet e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) euro. Ky qëndrim vjen në përputhje edhe me praktikën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në vendimin nr. 6, datë 17.3.2022.*

*Vlerësoj të sqaroj se nga ana e Komisionit të ardhurat e saj kanë filluar të përlllogariten nga muaji shtator dhe për shpenzimet e jetesës nuk ndiqet e njëjta logjikë pasi ato janë përlllogaritur që nga muaji janar. Nëse ndjekim logjikën e sipërcituar që shpenzimet vjetore duhet të përlllogariten të plota për vitin 2009 duhet që edhe të ardhurat të merren në mënyrë të plotë.*

*Në këto kushte vlerësoj se shpenzimet e saj të jetesës për vitin 2009 duhet të përlllogariten për 4 muaj, të cilat në total shkojnë 45.540 (dyzet e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekë, ndaj kërkoj që në analizën time financiare të reflektohet ndryshimi përkatës.*

**14.51** Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur parashtrimet e tij lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të përdorura për pjesën e tij të investimit në shumën 36.764 (tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro, për krijimin e pasurisë së analizuar më lart, si vijon:

*“Kredia është marrë me qëllim shlyerjen e shumës marrë F. H., ajo është me afat 15-vjeçar dhe vazhdon të shlyhet edhe sot nga unë. Vlerësoj të sqaroj paraprakisht se huaja e marrë nga ana ime shtetasit F. H. nuk është deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie për shkak të faktit se ajo është përdorur vetëm për rreth 3 muaj derisa u lëvrua dhe disbursua kredia nga ‘Tirana Bank’ sh.a. dhe duke qenë se ky veprim ka filluar dhe përfunduar brenda të njëjtit vit deklarimi nuk përmbushte kriterin ligjor si hua me detyrim deklarimi nga ana ime pranë ILDKPKI-së.*

Paraprakisht vlerësoj të theksoj se konstatimi i Komisionit se kam shtuar burimin në blerjen e kësaj pasurie gjatë hetimit administrativ nuk është i bazuar në prova dhe e kundërshtoj atë. Marrëdhënia ime me shtetasin F. H. rezulton tërësisht e provuar nga Kontrata e Huas nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.6.2013; Deklarata Noteriale nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 23.10.2013, nga praktika e kredisë pranë 'Tirana Bank', përshkrimi i përdorur nga ana ime në mandatin bankar të vitit 2013 për kthimin e huas F. H., si dhe mandatpagesa në favor të '\*\*\*' sh.p.k., me përshkrim 'kursime plus huamarrje'. Dokumente këto, të cilat janë krijuar të gjitha në vitin 2013, pothuajse 10 vjet përpara deklarimeve të mia dhënë Komisionit.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit që Deklarata Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.10.2013, nuk është e regjistruar në regjistrin e noterëve, vlerësoj të sqaroj se: së pari, regjistrimi i akteve noteriale në regjistrin noterial nuk është dhe nuk mund të jetë përgjegjësi e subjekteve pjesëmarrës në veprim juridik, por është përgjegjësi e noterit. Së dyti, në nenin 690 të Kodit Civil përcaktohet se kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj. Në zbatim të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, duke qenë se kontrata e mësipërme është lidhur përpara noterit ajo përbën provë me fuqi të plotë provuese. Ndërsa në referim të nenit 257 të po këtij Kodi, shkresat që përpilohen në bazë të nenit 253 për kryerjen ose vërtetimin e veprimit juridik, për sa u përket deklarimeve të palëve, përbëjnë provë të plotë për të gjithë. Qëndrim ky i mbajtur edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në vendimet nr. 5, datë 18.2.2019 dhe nr. 10, datë 14.4.2022. Së treti, mosreflektimi i deklaratës në regjistër, mund të jetë harresë e zakonshme që ndodh në praktikë. Qëndrim ky i mbajtur edhe nga ana e Komisionit në vendimin nr. 576, datë 20.10.2022.

Objekt i hetimit në lidhje me kriterin e pasurisë janë pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, si dhe të ardhurat që kanë mundësuar krijimin e tyre. Në rastin konkret, e ardhura që ka mundësuar krijimin e 1/2 së apartamentit tim është kredia e marrë nga 'Tirana Bank' dhe jo huaja rreth 4 muaj e marrë shtetasit F. H. Kredia ka ekzistuar në muajin dhjetor të vitit 2013 dhe në momentin e plotësimit të deklaratës Vetting. Ndërsa huaja nuk ka ekzistuar në ato momente.

Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit F. H., ashtu sikurse ju ka rezultuar e provuar nga hetimi administrativ, ky shtetas ka pasur mundësi dhe burime të ligjshme për të më dhënë hua shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro. Rezulton se:

- Vetëm nga llogaria e tij (personale) rrjedhëse në lekë, pranë 'Raiffeisen Bank', me nr. \*\*\*, rezulton e provuar se nga data 23.2.2012 deri në datën 26.2.2013 ai ka tërhequr cash, në total, shumën 4.487.789 (katër milionë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë.

- Ai po në të njëjtën bankë disponon edhe llogarinë personale në lekë me nr. \*\*\*, ku rezulton e provuar se tërheqjet cash të bëra prej tij deri në muajin maj 2013 kanë qenë në shumën totale 7.171.658 (shtatë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë.

- Nga llogaria e tij në 'Tirana Bank' All. me nr. llogarie:\*\*\*, tërhequr në periudhën maj 2008 - qershor 2008 shumën 431.000 (katërqind e tridhjetë e një mijë) lekë.

- Nga llogaria e tij në 'ProCredit Bank' me nr. \*\*\* rezulton se në periudhën qershor 2010 - dhjetor 2011 ka tërhequr shumën 807.700 (tetëqind e shtatë mijë e shtatëqind) lekë.

Nga të dhënat e mësipërme rezulton e provuar se personi fizik '\*\*\*' ka pasur qarkullim financiar dhe fitim të konsiderueshëm në vite.

*Njëkohësisht, nga Kontrata Premtim-Shitje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.1.2013, F. H. rezulton si palë premtim shitje lidhur me shitjen e dy pasurive në pronësi të tij, trullit me sipërfaqe 3.750 m<sup>2</sup> dhe 60 m<sup>2</sup> ndërtesë dhe truall me sipërfaqe 1.900 m<sup>2</sup>. Në këto pasuri ndodhet aktiviteti i biznesit të këtij shtetasi dhe në këtë pronë është vendosur një stok me materiale (qymyr, gëlqere, zhavorr etj.). Në kontratë parashikohet që stoku do të transferohet në datën e lidhjes së kontratës në posedim të palës blerëse dhe kjo e fundit të merrte përsipër shitjen e materialit të palës të treta. Çmimi i pasurive do të jetë 100.000 (njëqind mijë) euro. Pala e premtimit për blerje deklaronte se shuma prej 4.500.000 lekësh i është parapaguar cash shtetasit F. H. jashtë zyrës noteriale.*

*Referuar lëvizjeve të llogarive personale bankare të shtetasit F. H., nga të cilat rezulton se deri në muajin maj të vitit 2013 ai ka kryer tërheqje në vlerën mbi 13.000.000 (trembëdhjetë milionë) lekë (më shumë se trefishin e vlerës së dhënë hua), qarkullimit financiar si dhe fitimeve të realizuara në vite si person fizik, si dhe garancisë së marrë nga shtetasi A. H. në vitin 2013, në shumën 4.500.000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë, rezulton tërësisht e provuar mundësia financiare dhe burimet e ligjshme të shtetasit F. H. në dhënien e huas.*

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm**

**14.52** Trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit në raport me barrën e provës, si dhe dëgjoi atë në seancë dëgjimore, vlerëson sa vijon në lidhje me barrën e provës.

- i. Lidhur me marrëdhënien e bashkëpronësisë dhe pjesën takuese të subjektit të rivlerësimit në pasurinë apartament me sipërfaqe 91.91 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, blerë me Kontratën e Porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.5.2013, për çmimin 73.528 (shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e tetë) euro, trupi gjykues çmon se elementet e rezultuara nga hetimi, konkretisht, pagesat e kryera në bankë në datat 14 dhe 15 maj 2013 nga shtetasit A. Ç. dhe E. Zh. të vlerësuara në raport edhe me veprime të mëvonshme si shitja nga ana e znj. E. Zh. të pjesës së saj takuese, për vlerën 40.000 (dyzet mijë) euro, transaksion i kryer përmes bankës, administrimi dhe mbajtja e shumës në llogarinë e saj dhe më pas investimi i saj në krijimin e një pasurie të re, megjithëse janë kryer pas plotësimit të deklaratës *Vetting* vlerësohet se duhen çmuar si prova, pasi krijojnë bindjen se znj. E. Zh. ka qenë realisht bashkëpronare në 50% pjesë takuese në krijimin e pasurisë objekt hetimi. Trupi gjykues krijoi bindjen se pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit Arbër Çela është 50%. Parë në këtë këndvështrim, trupi gjykues vlerëson se edhe hetimi lidhur me burimet e ligjshme duhet bërë deri në vlerën 36.764 (tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro, e duke e konsideruar shtetasen E. Zh. si investitore dhe jo një person tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit. Ky qëndrim i Komisionit mbështetet dhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaccëm të Apelimit.<sup>26</sup>
- ii. Lidhur me burimin e të ardhurave të bashkëpronares E. Zh., nga tërësia e provave dhe dokumentacionit të mbledhur gjatë hetimit dhe provave të reja të paraqitura nga subjekti në parashtrime, rezulton se ajo ka qenë e punësuar që prej muajit tetor të vitit 2008 pranë shoqërisë “\*\*\*\*”. Më tej ka vijuar prej muajit gusht të vitit 2009 si e punësuar pranë Ambasadës Turke, e provuar kjo nga vërtetimet e lëshuara nga institucioni punëdhënës (ambasada).

Marrëdhënia e punësimit të znj. E. Zh. pranë Ambasadës Turke provohet nga vërtetimet ndër vite të lëshuara nga punëdhënësi, por edhe nga ISSH-ja, e cila deklaroi punësimin e saj që prej vitit 2009 e në vijim me pagë minimale.

<sup>26</sup> Shih vendim nr.22 datë 22.06.2022 dhe nr.14 datë 15.06.2021

Ka rezultuar e provuar se gjatë kohës që kjo shtetase ka qenë e deklaruar pranë sigurimeve shoqërore me pagë minimale në monedhën lekë, në llogarinë bankare të saj të pagës është kanalizuar paga mujore në euro, e cila është disa herë më e lartë dhe se përputhet me vërtetimet e lëshuara nga ambasada.

Trupi gjykues, në analizë të këtyre fakteve, ka pranuar të llogarisë të ardhurat e znj. E. Zh. sipas vërtetimeve të lëshuara nga banka, kjo edhe për faktin se pasuria e krijuar prej saj nuk është një pasuri e subjektit të rivlerësimit, por e znj. E. Zh. Komisioni, parë në këtë këndvështrim, në analizën e saj lidhur me burimet, duhet të fokusohet te burimet financiare për të vlerësuar kapacitetin dhe mundësitë e saj për të krijuar këtë investim, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se ajo mund të ishte një pasuri e subjektit të rivlerësimit. Parë në këtë këndvështrim, shtetasja E. Zh. ka pasur mundësi financiare të kursej të ardhura me burim nga pagat (duke përfshirë të ardhurat nga punësimi që prej vitit 2008 në shoqërinë “\*\*\*\*” e pas zbritjes së shpenzimeve jetike) deri në shumën 26.000 (njëzet e gjashtë mijë) euro [nga e cila shuma prej 10.285 (dhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) euro ka qenë e investuar në depozita kursimi, tërhequr ditën që është kryer pagesa në shoqërinë e ndërtimit].

Lidhur me kontratën e huas për vlerën 8.000 (tetë mijë) euro të vitit 2017, trupi gjykues vlerëson se kjo hua është deklaruar si burim në deklaratën *Vetting* dhe se kanë rezultuar gjurmë të mëvonshme në lëvizjet e llogarisë bankare në BKT lidhur me shlyerje të pjesshme.

Lidhur me Kontratën e Huas për vlerën 10.000 (dhjetë mijë) euro, të deklaruar gjatë hetimit administrativ nga Komisioni dhe të dokumentuar me deklaratë noteriale të vitit 2019, trupi gjykues vlerëson se ajo është deklaruar vetëm gjatë hetimit standard dhe Deklarata e vitit 2019 nuk përbën ndonjë vlerë provuese për këtë proces.

Duke vlerësuar se znj. E. Zh. nuk është një person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues çmon se subjekti ka arritur të provojë në mënyrë bindëse dhe të pakontestueshme ekzistencën reale të kësaj marrëdhënieje, po ashtu edhe është përpjekur për sa ka pasur mundësi të tregojë lidhur me burimet e financimit të bashkinvestitores në krijimin e pasurisë. Trupi gjykues arsyeton se shtetasja E. Zh., në cilësinë e bashkëpronares, nuk ka pasur detyrim ligjor që të ardhurat e përfituara nga paga t’i nënshtroheshin nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

Nga vështrimi i llogarive bankare të znj. E. Zh. krijohet bindja se pjesa takuese prej 50% në pasurinë apartament me sipërfaqe 91.91 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, blerë me Kontratën e Porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.5.2013, për çmimin 73.528 (shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e tetë) euro, është investim i saj dhe se ajo ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie. Kjo analizë është bërë për të shpjeguar mbi çdo dyshim të arsyeshëm të ngritur gjatë hetimit lidhur me pjesën takuese të subjektit të rivlerësimit Arbër Çela dhe vlerën financiare të investuar prej tij.

Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën *Vetting* të huas nga shtetasi F. H., si burim në momentin e krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 91.91 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, trupi gjykues arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë burimin në momentin e krijimit të pasurisë, me qëllim verifikimin nga ana e Komisionit të këtyre burimeve, si dhe të marrëdhënies së huamarrjes. Në vlerësim të fakteve dhe dokumenteve të hetimit rezulton e provuar se qëllimi i kredisë në “Tirana Bank” ka qenë blerja e apartamentit në rrugën “\*\*\*\*”, e provuar edhe në kontratën e kredisë të firmosur nga palët, ku përcaktohet se subjekti i rivlerësimit duhet të vendosë kolateral për mbulimin e kredisë, objektin e financimit, në momentin që kjo pasuri do të regjistrohej. Duke qenë se



marrëdhënia e huas rezulton e provuar me dokumentacion provues të kohës kur ka ndodhur ky transaksion, periudha kohore nga kjo huadhënie deri tek shlyerja e saj nëpërmjet kredisë është e shkurtër, trupi gjykues vlerëson se ky mosdeklarim nuk është i qëllimshëm nga ana e subjektit të rivlerësimit, duke vendosur ta pranojë dhe analizojë atë.

- iii. Lidhur me mundësitë financiare të huadhënësit F. H., nga hetimi ka rezultuar si vijon:
  - a. Kontrata e vitit 2013 lidhur midis shtetasve F. H. dhe A. H., ku të dyja palët kanë rënë dakord se shtetasi A. H. i ka dhënë parapagim shtetasit F. H. shumën 4.500.000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë, provohet marrëdhënia ligjore e premtim-shitjes midis këtyre dy shtetasve dhe në konsekuencë dhënia parapagim e shumës 4.500.000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë *cash* jashtë zyrës noteriale. Rezulton e faktuar se kjo kontratë është e lidhur midis dy individëve dhe jo shoqërive përkatëse dhe, për këtë arsye, kjo shumë parapagim nuk është shoqëruar me faturë tatimore dhe, në vijim, të përmbajtjes së kontratës nëse stoku i materialeve nuk do të arrihej të shitej nga pala blerëse, atëherë kjo shumë do të kthehej mbrapsht nga shitësi, shtetasi F. H.
  - b. Shpjegimet e subjektit mbi marrëdhënien kontraktore, ekstraktin historik të shtetasit F. H., PF, llogarinë bankare të shtetasit F. H. në “Raiffeisen Bank” si kalime fondesh në shumën totale 7.685.000 (shtatë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) lekë me përshkrimin “nga shpronësimet” dhe se ky shtetas në vitin 2015 ka pezulluar aktivitetin e tij pa afat, rezultojnë të provuara e të vërteta.
  - c. Shtetasi F. H. ka pasur qarkullim financiar dhe fitime të konsiderueshme ndër vite dhe se ai ka pasur likuiditete të bollshme në llogaritë e tij personale të investuara në bono thesari/depozita qysh prej vitit 2004 dhe se në llogaritë e tij rrjedhëse kanë rezultuar tërheqje personale në shumën 3.787.789 (tre milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë në periudhën 2012 – 5.2013 nga llogaritë e tij personale *cash cover*/kredi e mbuluar me depozitë.
  - d. Trupi gjykues arsyeton se nga tërësia e provave të mbledhura gjatë hetimit rezulton se nga provat direkte dhe ato indirekte, shtetasi F. H. ka pasur mundësi financiare të japë hua në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro për një afat të shkurtër kohor dhe se provohet se shuma e kredisë së disbursuar nga “Tirana Bank” është përdorur për shlyerjen e huas shtetasit F. H. me transfertë bankare. Shtetasi F. H. ka pasur qarkullim të likuiditeteve, e përderisa shuma e dhënë hua është kthyer brenda vitit ushtrimor financiar edhe pagimi i taksave e tatimeve bëhet në fund të vitit ushtrimor, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi subjekti në zbatim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në vlerësim të trupit gjykues huadhënia rezulton e dokumentuar/provuar dhe bindëse. Subjekti i rivlerësimit ka përmbushur detyrimin e nenit 32, pika 4, duke provuar marrëdhënien e huamarrjes dhe duke treguar burimet e huadhënësit. Nga vështrimi i përgjithshëm i gjendjes së likuiditeteve të huadhënësit rezultojnë të ardhura në sistemin bankar, rezulton qarkullim në aktivitetin e biznesit si person fizik, po ashtu edhe kontrata financiare. Për sa kohë që tatimi paguhet në fund të vitit ushtrimor dhe marrëdhënia e huas ka ndodhur për një periudhë të shkurtër brenda vitit ushtrimor, të ardhurat/likuiditetet e huadhënësit përbëjnë një burim të ligjshëm në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016.
  - e. Trupi gjykues vlerëson se për sa kohë u provua se shtetasi F. H. kishte likuiditete të disponueshme në llogaritë e tij bankare, si dhe aktivitet tregtar e kontrata pune, u gjetën gjurmë të ekzistencës së kësaj marrëdhënieje ndër vite, kjo marrëdhënie nuk mund të ketë shërbyer si një mjet për të justifikuar mungesë të burimeve të ligjshme, deklarim të rremë, fshehje pasurie apo situatë konflikti interesi, nuk

vlerësohet si deklaram i pamjaftueshëm në kuptim të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**14.53** Trupi gjykues, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet analizës dhe çmuarjes së provave të administruara gjatë procesit të hetimit, akteve të administruara, dëgjimit të parashtrimeve të subjektit në seancë publike, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, konkludon se investimi i subjektit të rivlerësimit në pasurinë apartament banimi në Tiranë është në shumën 36.764 (tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro (ose 50%), duke e konsideruar znj. E. Zh. si bashkinvestitore në këtë pasuri. Në këtë konkluzion të arritur nga trupi gjykues rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë. Lidhur me mundësitë financiare me burime të ligjshme për të investuar shumën 36.764 (tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro, nga hetimi rezultoi se ai ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e saj, duke pranuar dhe marrë në konsideratë huan e shtetasit F. H. si burim primar në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) euro dhe kredinë hipotekore të marrë brenda viti 2013 si burim fundor, kursimet e tij në shumën 387.540 (treqind e tetëdhjeta e shtatë mijë e pesëqind e dyzet) lekë [2.764 (dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro], si dhe dhuratë nga prindërit në shumën 4.000 (katër mijë) euro.

**14.54** Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në analizën e mësipërme, arriti në përfundimin lidhur me pasurinë objekt kontrolli të subjektit të rivlerësimit Arbër Çela se pasuria e tij është e ligjshme në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016.

**15. Pasuria automjet tip “\*\*\*\*”, viti i prodhimit 2007, i blerë me Kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.10.2016, kundrejt shumës 4.000 (katër mijë) euro. Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: kursimet personale në shumën 2.000 (dy mijë) euro dhe huamarrje prej prindërve në shumën 2.000 (dy mijë) euro.**

**15.1** Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka përcjellë<sup>27</sup> për Komisionin dosjen e automjetit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së rezulton se:

i) Automjeti tip “\*\*\*\*”, viti i prodhimit 2007, rezulton se është blerë nga shtetasi E. S. sipas aktit të shitjes nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2014, me palë shitëse shoqërinë “\*\*\*\*”. Sipas faturës tatimore të shitjes, çmimi i blerjes së automjetit nga shtetasi E. S. është 840.000 (tetëqind e dyzet mijë) lekë. Sipas Certifikatës së Pronësisë datë 26.11.2014, ky automjet figuron i regjistruar në emër të shtetasit E. S.

ii) Nëpërmjet Kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.10.2016, me palë shitëse shtetasin E. S., automjeti është blerë nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 4.000 (katër mijë) euro, ose 541.080 (pesëqind e dyzet e një mijë e tetëdhjetë) lekë, e cila është paguar jashtë zyrës noteriale.

iii) Ky automjet është shitur nga subjekti i rivlerësimit sipas Kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.2.2019, shtetases A. Xh. kundrejt vlerës 3.000 euro ose 366.510 (treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e dhjetë) lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

**15.2** Subjekti i rivlerësimit ka deklaram në pyetësonin standard<sup>28</sup> se para fitimit të pronësisë e ka përdorur këtë automjet në periudha të ndryshme gjatë viteve 2014 - 2015 për udhëtime jashtë shtetit në rrugë të gjata dhe në muajin tetor të vitit 2016 i është ofruar shtetasit E. S. për blerjen e tij.

<sup>27</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2022.

<sup>28</sup>Shihni përgjigjen nr. 8 të pyetësonit standard datë 31.8.2020.

**15.3** Nga hetimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi automjetin me targa \*\*\*, i cili është hequr nga qarkullimi në datën 9.10.2014 dhe se nuk ka pasur automjet në pronësi për periudhën 2014 – 2016.

**15.4** Në procesverbalin e mbajtur në datën 20.10.2014 pranë ILDKPKI-së<sup>29</sup>, i pyetur nëse përdor ndonjë automjet me ose pa prokurë, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Aktualisht jam fare pa makinë. Për problemet e punës kam përdorur automjetin e gjykatës”*.

**15.5** Nga të dhënat e sistemit AMF figuron se në emër të subjektit të rivlerësimit është prerë kartoni jeshil si përdorues. Sipas të dhënave të sistemit *TIMS* rezulton se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar me këtë automjet gjatë vitit 2015, përkatësisht, në datat 3.1.2015, 23.1.2015, 10.4.2015, 27.5.2015, 6.8.2015, 14.8.2015, 1.10.2015, 28.12.2015 dhe gjatë vitit 2016 para nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, përkatësisht në datat 14.1.2016 dhe 15.6.2016. Në total rezultojnë 10 udhëtime jashtë shtetit me këtë automjet.

**15.5.1** Nga verifikimi i kryer në sistemin *TIMS* për shtetasin E. S. rezulton se nuk ka udhëtuar jashtë vendit, përveçse për herë të parë në datën 2.6.2017, së bashku me subjektin e rivlerësimit me këtë automjet dhe në datën 24.12.2017 ky automjet është përdorur nga ana e tij për udhëtim brenda ditës nëpërmjet pikës kufitare Hani i Hotit.

**15.6** Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit për marrëdhënien e tij me shtetasin E. S. dhe, në përgjigjen e pyetësorit datë 7.7.2022<sup>30</sup>, ka shpjeguar se: *“Në lidhje me marrëdhënien time me shtetasin E. S. deklaroj se me këtë shtetas kam miqësi disavjeçare”*.

**15.7** Komisioni ngre dyshime se subjekti i rivlerësimit ka shmangur blerjen e kësaj pasurie dhe deklarimin e saj në vitin 2014.

**15.8** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2016 si burim të ardhurash për blerjen e automjetit tip “\*\*\*\*” kursimet personale të tij dhe të bashkëshortes E. B., në shumën 2.000 (dy mijë) euro: *“Pakësuar likuiditeti cash në vlerën aktuale në shumën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Nga analiza e deklarimeve të gjendjes cash rezulton se në fund të vitit 2015 gjendja cash është në shumën 560.000 (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe në vitin 2016, kjo gjendje cash është pakësuar me shumën 410.000 (katërqind e dhjetë mijë) lekë”*.

**15.9** Duket se subjekti i rivlerësimit ka kursime personale me burime të ligjshme në shumën 2.000 (dy mijë) euro, ekuivalent në shumën 270.540 (dyqind e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet) lekë në gjendje *cash*, të cilat mund të jenë përdorur si burim për blerjen e automjetit.

**15.10** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar si dokumentacion provues në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.1.2017, me palë deklaruese shtetasin I. Ç., si dhe vërtetimet e pagës për prindërit.

**15.11** Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit duket se prindërit e subjektit kanë pasur likuiditete dhe të ardhura që të justifikojnë dhënien e huas në shumën 2.000 (dy mijë) euro në vitin 2016.

**15.12** Në përfundim, duket se subjekti i rivlerësimit është sjellë si pronar i ligjshëm i automjetit tip “\*\*\*\*”, që në vitin 2014, dhe se ka shmangur blerjen dhe deklarimin e tij prej tetorit të vitit 2014. Nga analiza financiare për vitin 2014 subjekti rezulton në pamundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie.

<sup>29</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2022.

<sup>30</sup>Shihni përgjigjen nr. 5 të pyetësorit datë 7.7.2022.

**15.13** Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë shpjegime bindëse lidhur me konstatimet e bëra.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**15.14** Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur parashtrimet e tij lidhur me shpjegimet e kërkua nga Komisioni, si vijon:

*“Theksoj se në përgjigje të pyetësorit standard kam deklaruar se në periudha të ndryshme gjatë viteve 2014 - 2015 për udhëtime jashtë shtetit në rrugë të gjata kam përdorur automjetin ‘\*\*\*’. Fakti që këtë automjet e kam përdorur vetëm për udhëtime jashtë shtetit dhe që, në total, ashtu siç keni konstatuar edhe ju janë 10 udhëtime (në një periudhë dyvjeçare), nuk nënkupton dhe aq më pak nuk ka asnjë arsye për të dyshuar se kam shmangur blerjen e këtij automjeti apo deklarimin në vitin 2014. Nuk kam shmangur blerjen e asnjë automjeti, nuk jam sjellë si pronar i saj dhe as nuk kam pasur detyrimin për të deklaruar përdorimin e këtij mjete në DPV-të e vitit 2014 apo 2015, duke qenë se në DPV (para deklaratës Vetting) nuk parashikohej detyrimi për të deklaruar pasuritë në përdorim (siç u parashikua në deklaratën Vetting). Ky automjet është blerë dhe ka qenë në pronësi të shtetasit E. S. (me të cilin kam miqësi prej vitesh) deri në datën 29.10.2016. Fakti që unë e kam përdorur këtë automjet disa herë për udhëtime jashtë shtetit nuk më bën pronar të tij dhe as nuk mund të ngrejë dyshime për fshehje.*

*Nuk ka asnjë policë të sigurimit vjetor në emrin tim për këtë automjet, nëse automjeti do të përdorej nga unë brenda vendit minimalisht do të rezultonte edhe emri im në policat e sigurimit, duke qenë se në policat e sigurimit vendoset emri i pronarit, por edhe emra të përdoruesve të mundshëm.*

*Tjetër fakt që duhet të mbahet në konsideratë është edhe fakti se shtetasi E. S. nuk ka rezultuar në pamundësi financiare për të blerë automjetin, rrethanë që mund të çonte në lindjen e dyshimeve për pronësinë e mjetit. Bashkëngjitur do të paraqes si provë deklarimin e pagës së shtetasit E. S. dhe të prindërve të tij, ku rezulton se prindërit e tij kanë qenë në marrëdhënie pune prej vitesh, ndërkohë që ky shtetas ka qenë në marrëdhënie pune prej vitit 2009. Në këto kushte, ai ka pasur mundësi të plotë ekonomike për të blerë automjetin tip ‘\*\*\*’ me çmimin në shumën 840.000 (tetëqind e dyzet mijë) lekë.*

*Faktet e mësipërme provohen me provat si më poshtë vijon, të cilat do i depozitohet bashkëlidhur: deklaratë noteriale e shtetasit E. S.; vërtetim nga ISSH-ja për E. S.; vërtetim nga ISSH-ja për A. S.; vërtetim nga ISSH-ja për Z. S.; certifikatë familjare A. S.; deklaratën time periodike vjetore të vitit 2016 dhe policat e sigurimit të automjetit në vitet 2014 – 2016, të cilat ju i dispononi”.*

**15.15** Trupi gjykues i vlerëson shpjegimet e subjektit bindësepo ashtu ai ka provuar mundësitë financiare të shtetasit E. S. për të blerë automjetin në vitin 2014. Në vijim, komisioni ka pranuar shpjegimet duke reflektuar blerjen e pasurisë automjet në analizën financiare në vitin 2016 në shumën 4.000 (katër mijë) euro sipas kontratës së shitblerjes.

**16.** DPT-ja ka përcjell informacion për shtetasin I. Ç. i regjistruar për ushtrim aktiviteti tregtar privat: *“Mjek për shërbime shëndetësore në ndërmarrje”* me adresë: *“Fier – Lushnjë, Lushnjë, lagjja ‘\*\*\*’, rruga ‘\*\*\*’, godinë \*\*\*katëshe, me nr. pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, në katin e \*\*\*”.*

**16.1** Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se babai i tij qëndron në pjesën më të madhe të kohës në qytetin e Lushnjës, duke paguar qira për shkak se vazhdon të jetë i angazhuar në marrëdhënie pune në disa biznese ku është i kontraktuar si specialist i jashtëm.

**16.3** Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit për marrëdhënien e babait të tij me këtë adresë. Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar: *“Në lidhje me marrëdhënien e babait tim I. Ç. me adresën: Lagjja ‘\*\*\*’, rruga ‘\*\*\*’, godinë \*\*\*-katëshe, me nr. pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, kati\*\*\*. Kjo adresë është adresa e biznesit të shoqërisë ‘Përpunim mermer granit’ sh.p.k., me administrator z. A. Xh., ku është i punësuar part time babai im dhe është e regjistruar adresa e personit fizik ‘\*\*\*’. Bashkëlidhur do ju vendos në dispozicion vërtetimin e punës së babait tim”.*

**16.4** Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se kjo çështje nuk lidhet me procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin Arbër Çela dhe se nuk ka *indicie* për të ngritur dyshime pasi pasuria e shitur nga prindërit e subjektit të rivlerësimit në qytetin e Lushnjës, aktualisht është e regjistruar në emër të pronarit të ri.

## **17. Analiza financiare**

**17.1** Nga analiza financiare e kryer nga njësia e shërbimit ligjor, subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare:

- i) në vitin 2012 për pagesën e shpenzimeve familjare përkatësisht në shumën - 38.082 (tridhjetë e tetë mijë e tetëdhjetë e dy) lekë;
- ii) në vitin 2013 në shumën -7.304.299 (shtatë milionë e treqind e katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë, për pagesën e pasurisë apartament dhe krijimit të likuiditeteve *cash* (shihni pasurinë e parë);
- iii) në vitin 2014 në shumën -952.345 (nëntëqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e dyzet e pesë) lekë (në këtë vit është llogaritur dhe përfshirë në analizë edhe blerja e automjetit tip “\*\*\*”).

**17.2** Situata negative financiare rezulton në shumën -8.294.720 (tetë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëzet) lekë. Në bazë të nenit 52 të ligjit nr.84/2016 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të shpjeguar e provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**17.3** Në shpjegimet e tij subjekti ka kërkuar rishikimin e shpenzimeve të udhëtimeve për vitet 2012, 2013 dhe 2014<sup>31</sup>. Subjekti rivlerësimit i ka qëndruar shpjegimeve lidhur me krijimin e pasurisë apartamentet të trajtuar më lartë.

## **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm**

**17.4** Trupi gjykues, pasi ka marrë në konsideratë shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka reflektuar ndryshimet si vijon:

**17.4.1** Në vitin 2012 janë reflektuar ndryshimet lidhur me shpenzimet e qëndrimit, të cilat janë llogaritur në shumën e pretenduar nga subjekti, të shpenzuar për dy udhëtimet e vitit 2012.

**17.4.2** Në vitin 2013 janë reflektuar ndryshimet lidhur me katër udhëtimet e pretenduara nga subjekti duke marrë në konsideratë kërkesën e tij për të ulur shpenzimet e llogaritura bazuar edhe në provat e paraqitura (deklaratat noteriale), si dhe janë pranuar shpjegimet e dhëna për krijimin e pasurisë apartament banimi në Tiranë.

**17.4.3** Në vitin 2014 janë reflektuar ndryshimet lidhur me udhëtimin që është paraqitur deklarata noteriale, ndërkohë lidhur me udhëtimin e datave 23.5.2014 - 26.5.2014 nuk janë pasqyruar ndryshime në shpenzimet e llogaritura, pasi nuk është paraqitur dokumentacion provues lidhur me subvencionimin e shpenzimeve të qëndrimit. Në vitin 2014 është reflektuar ndryshimi lidhur me automjetin tip “\*\*\*”, duke zbritur

<sup>31</sup> Për më shumë referoju shpjegimit tdhënë në përgjigjet mbi rezultatet e hetimit.

vlerën e automjetit 840.000 (tetëqind e dyzet mijë) lekë në vitin 2014 dhe duke llogaritur vlerën e këtij automjeti në vitin 2016 sipas vlerës së kontratës 4.000 (katër mijë) euro [541.080 (pesëqind e dyzet e një mijë e tetëdhjetë) lekë].

**17.5** Në përfundim ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare në shumë minimale prej -282.639 (dyqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) lekësh për pagesën e shpenzimeve të tij familjare, përkatësisht: në vitin 2013 në shumën 105.367 (njëqind e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë; në vitin 2014 në shumën 79.677 (shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë; dhe në vitin 2016 në shumën 97.595 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë, duke e vlerësuar këtë situatë negative financiare të pamjaftueshme për aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

### **Konkluzione për kriterin e vlerësimit të pasurisë**

Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se e vetmja pasuri e paluajtshme e subjektit të rivlerësimit, deri në deklaratën *Vetting*, është 50% e vlerës së një apartamenti me sipërfaqe 91.91 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, blerë me Kontratë Porosie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.5.2013, për çmimin 73.528 (shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e tetë) euro. Vlera e pjesës në pronësi të subjektit të rivlerësimit Arbër Çela është në shumën 36.764 (tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro, për të cilën ai ka një marrëdhënie kreditimi me bankën për vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) euro qysh prej vitit 2013.

Trupi gjykues, pasi vlerësoi marrëdhënien pasurore të deklaruar nga subjekti, e analizoi atë në tërësi, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në konkluzionin se pasuria e subjektit të rivlerësimit rezulton të jetë e ligjshme dhe se nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Për rrjedhojë, trupi gjykues ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit Arbër Çela ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLI I FIGURËS**

**18.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar në datën 2.11.2017 raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin Arbër Çela, i cili nuk përmbante mendimin e njërit prej autoriteteve verifikuese (raport i padeklasifikuar).

**19.** Pas shortimit të subjektit të rivlerësimit dhe me fillimin e hetimit administrativ, Komisioni i ka kërkuar DSIK-së rishikimin e raportit të dërguar prej tyre në datën 2.11.2017, i cili ishte përgatitur pa përgjigjen e njërit prej organeve ligjzbatuese (i paplotë), duke përfshirë në vlerësim informacionin e plotë sipas parashikimeve ligjore, si dhe përditësim të informacionit e rifreskim të të dhënave dhe, në vijim, edhe deklasifikimin e raportit.

**20.** DSIK-ja ka përcjellë në datën 20.5.2022 raportin e rishikuar për subjektin Arbër Çela, deklasifikuar pjesërisht. Në përfundim të raportit, DSIK-ja ka konstatuar papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, si vijon:

*Në raportin e vlerësimit se subjekti i rivlerësimit ka dijeni (deklaruar edhe nga vetë ai) për një familjar të vetin (xhaxhai), i cili është shpallur fajtor nga Gjykata e Krimeve të Rënda për veprat penale të parashikuara në nenet 339, 79/c, 334/2 dhe 278/2 të Kodit Penal. Për shtetasin në fjalë disponohen të dhëna se ka qenë pjesëtar aktiv në një organizatë të mirorganizuar kriminale, që operonte në qytetin e Lushnjës, rreth viteve 1997 – 1998, i cili është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë me 25 vjet burgim.*

*Në vijim të informacioneve të ardhura nga autoritetet verifikuese në vlerësim të të dhënave që disponon, ka arsyetuar se duhet të merren parasysh elementet që evidentojnë përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme gjatë ushtrimit të detyrës, pasi në frymën e ligjit nr. 84/2016 vlerësohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjektit të rivlerësimit.*

**21.** Lidhur me konstatimin për kontaktin e papërshtatshëm, Komisioni vlerëson se rrethana e deklaruar nga subjekti nuk përbën rrethanë lehtësuese, meqenëse ajo është deklaruar prej tij, siç konstaton DSIK-ja në raport vlerësimi, pasi ai nuk mund të mos e deklaronte këtë rrethanë edhe si një fakt të njohur botërisht.

Në vlerësim të Komisionit, rrethanë lehtësuese konsiderohet fakti se kontakti i papërshtatshëm është një person në lidhje familjare/gjaku të afërt me subjektin e rivlerësimit, të cilin ai nuk ka zgjedhur ta ketë kontakt apo marrëdhënie miqësore, por përkundrazi është një rrethanë që nuk ka pasur mundësi ta shmangë. Ajo që duhet të zërë peshë në vlerësim është marrëdhënia konkrete dhe ekzistenca e saj nëpërmjet shkëmbimit të favoreve, dhuratave apo pasurive me këtë person, apo përfshirje në veprimtari të kriminale, apo lidhje me organizatën kriminale, apo takime edhe me persona të tjerë të përfshirë në këtë organizatë kriminale, lidhje biznesi, etj.

Në këtë kuadër dhe të detyrimeve të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, vlerësojmë se subjekti rivlerësimit ka qenë 16 vjeç në kohën e arrestimit (burgosjes) së këtij shtetasi (xhaxhait të tij) dhe se nuk kanë rezultuar të dhëna të mëvonshme për përfshirje në organizatën kriminale apo kontakte me persona të asaj organizate, lidhje biznesi, etj.

**22.** Lidhur me konstatimin tjetër për dyshime se subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, është përfshirë në veprime që kanë sjellë si pasojë shpërdorim detyre dhe/apo veprime korruptive, Komisioni ka vlerësuar të verifikojë të dhënat në formë *indiciesh*. Për këto të dhëna janë kërkuar materialet përkatëse (dosjet gjyqësore dhe/ose vendimet) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke u kryer nga Komisioni verifikimet përkatëse.

**22.1 Vendimi nr. \*\*\*, datë 25.9.2018<sup>1</sup>**, me palë kërkuese Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, i pandehur shtetasi N. P., akuzuar për kryerjen e veprave penale “prishje të qetësisë publike” dhe “mbajtje pa leje të armëve luftarake”. Prokuroria ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit, dënimin me 18 muaj burgim, duke përfituar në bazë të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale uljen e 1/3 të dënimit dhe në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit me burgim për një periudhë 2-vjeçare. Gjykimi i kësaj çështjeje nga gjyqtari Arbër Çela ka zgjatur në intervalin kohor 6.7.2017 - 25.9.2018. Nga verifikimi rezulton se për veprën penale “prishje e qetësisë publike”, objekt gjykimi në nenin 274 të Kodit Penal, parashikohet dënimi me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet, ndërsa për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe municionit” në nenin 278/1 të Kodit Penal parashikohet dënim me burgim nga 3 deri në 7 vjet. Prokurori, në pretencën e tij, ka kërkuar minimumin e masës së dënimit me burgim. Gjykata ka vendosur në përfundim të gjykimit deklarimin fajtor të të pandehurit N. P., dënimi i tij me 18 muaj burgim, në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale ulet me 1/3 e dënimit, duke u dënuar me 1 vit burgim dhe në bazë të nenit 63 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe detyrimin për të kryer një punë në interes publik për një kohë prej 60 orësh.

Kundër këtij vendimi nuk është paraqitur ankim dhe ai ka marrë formë të prerë në datën 10.10.2018.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit shpjegon se: “Së pari, i pandehuri N. P. ka qenë i mitur në kohën e kryerjes së veprës penale dhe, si rrjedhojë, përfitonte nga të gjitha parashikimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Në bazë të këtij ligji për veprat penale për të cilat ai akuzohej, gjykata nuk mund të caktojë dënim me burgim. Konkretisht, në vendim kam arsyetuar se: ‘Nga ana tjetër, duke marrë parasysh se i pandehuri është i mitur, gjykata i referohet ligjit nr. 37/2017 ‘Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur’, i cili parashikon se: ‘Burgimi ndaj një të mituri mund të zbatohet në rast se ai ka kryer një vepër penale për të cilën minimumi i dënimit të parashikuar është 7 vjet dhe kur ky dënim është i nevojshëm për shkak të natyrës, rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së fajësisë’. Në këto kushte, gjykata, duke qenë se vepra penale objekt akuze parashikon një dënim në maksimum deri në 7 vjet burgim, çmon se dënimi me burgim nuk mund të zbatohet dhe, si rrjedhojë, ndaj të pandehurit do të jepen masat alternative të parashikuara nga Kodi Penal e, konkretisht, gjykata çmon se duhet të aplikohet neni 63 i Kodit Penal, duke vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim me detyrimin që i pandehuri të kryejë një punë me interes publik, pa shpërblim për një periudhë prej 60-orësh.

Nga aktet e dosjes rezulton se çështja është gjykuar prej meje në një kohë shumë të shkurtër. Konkretisht, dosja është regjistruar në gjykatë në datën 6.7.2018 dhe është përfunduar më 25.9.2018. Gjykimi ka zgjatur më pak se dy muaj, duke marrë parasysh se ndërmjet ka qenë edhe muaji gusht, i cili është muaj pushimesh vjetore. Ka një gabim material në zbardhjen e vendimit gjyqësor, ku viti i ardhjes së çështjes në gjykatë është shënuar gabimisht 2017 dhe jo 2018. Kjo rezulton e provuar qartë jo vetëm nga fleta e shortit, por edhe nga leximi i faktit penal, i cili rezulton të jetë kryer në muajin shkurt 2018 (bashkëngjitur si provë fleta e shortit për këtë dosje penale).

Nga ana ime nuk është favorizuar në asnjë lloj forme i pandehuri i mitur dhe caktimi i dënimit është diktuar nga rregullat e posaçme të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili ndalon dhënien e një dënimi me burgim për veprat objekt akuze”.

**22.2 Vendimi nr. \*\*\*, datë 12.12.2016<sup>2</sup>**, me palë kërkuese Prokuroria e Rrethit Shkodër, të pandehur shtetasit A. L. dhe D. P., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve” kryer në bashkëpunim. Prokuroria ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurve dhe dënimin e secilit prej tyre me 7 vjet burgim. Kjo çështje është gjykuar në trup gjykues, ku kryesues ka qenë gjyqtari Arbër Çela. Gjukata ka vendosur në përfundim të gjykimit deklarinimin të pafajshëm të të pandehurit A. L., pasi nuk provohet të ketë kryer veprën penale objekt akuze. Për të pandehurin D. P. gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve” dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim.

Trupi gjykues ka vlerësuar se nga ana e Prokurorisë nuk ka prova të mjaftueshme për të bindur tej çdo dyshimi të arsyeshëm që i pandehuri A. L. ka kryer veprën penale objekt akuze. Lidhur me të pandehurin D. P. trupi gjykues ka vendosur ndryshimin e kualifikimit juridik të veprës penale në rrethanat kur nuk provohet që të jetë kryer në bashkëpunim.

Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është apeluar nga prokurori në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila ka vendosur në datën 19.4.2017 ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, duke deklaruar fajtor të dy të pandehurit për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve” kryer në bashkëpunim dhe dënimin e secilit prej tyre me 7 vjet burgim. Lidhur me vendimmarrjen e shkallës së parë, Gjykata e Apelit Shkodër ka konstatuar mangësi:

- Mosadministrimi si provë i komunikimeve të mëparshme telefonike mes dy të pandehurve në referim të pikës 3 të nenit 362 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se deklarinimet e dhëna para prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore



mund të vlerësohen si provë nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

- Analizim i gabuar i dëshmive të dhëna nga oficerët e policisë gjyqësore, të cilat kanë qenë të qarta duke konfirmuar bashkëfajësinë e dy të pandehurve.
- Dëshmia e të pandehurit D. P. gjatë gjykimit nuk gjen mbështetje në asnjë provë të administruar dhe, si rrjedhojë, ky deklaram nuk është i besueshëm dhe është bërë thjesht për të përfituar nga parashikimet ligjore lidhur me kualifikimin juridik të veprës penale.

Nga vlerësimi i rrethanave të çështjes, duket se vendimmarrja e trupit gjykues të shkallës së parë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal dhe në analizë të gabuar të provave duke deformuar rëndësinë e tyre me qëllim lehtësimin e pozitës së të pandehurve. Lirimi i të pandehurit A. L. duket se është kryer në kundërshtim dhe shkelje të ligjit procedural penal.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit shpjegon se: *Së pari, nuk qëndron konstatimi i Komisionit 'Mosadministrimi si provë i komunikimeve të mëparshme telefonike mes dy të pandehurve në referim të pikës 3 të nenit 362 të Kodit të Procedurës Penale'.*

*Nga ana e të pandehurve, në asnjë moment nuk është mohuar njohja me njëri-tjetrin, madje u pretendua edhe një konflikt që kishin midis tyre për shkak borxhi, konflikt që rezulton dhe nga mesazhet e shkëmbyera. Ndaj kam arsyetuar se: '...nga ana e Prokurorisë në asnjë moment nuk u arrit të hidhej poshtë alibia e të pandehurit A. L. se ai ka shkuar në banesën e të pandehurit D. P. për një borxh që ky i fundit i kishte. Nga dëshmia e dëshmitares A. L. pranohet ekzistenca e një borxhi midis të pandehurit A. dhe D.. Po ashtu vetë i pandehuri D. P. mohon kategorikisht që i pandehuri A. L. të ketë pasur dijeni për lëndën narkotike'.*

- i) *Nga ana e Komisionit referohet në nenin 362 të Kodit të Procedurës Penale që lidhet me kundërshtimin e dëshmisë. Konkretisht, në nenin 362 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: 'Për të kundërshtuar tërësisht ose pjesërisht përmbajtjen e dëshmisë ose kur refuzon të dëshmojë, palët mund të përdorin thëniet e bëra më parë nga dëshmitari para prokurorit ose policisë gjyqësore dhe që ndodhen në fashikullin e prokurorit, por vetëm pasi dëshmitari ka deponuar mbi faktet dhe rrethanat që kundërshtohen. 2. Këto thënie nuk përbëjnë provë në vetvete për faktet që pohohen në to, por ato mund të vlerësohen nga gjykata për të përcaktuar besueshmërinë e personit të pyetur dhe përfshihen në fashikullin e shqyrtimit gjyqësor. 3. Deklarimet e dhëna para prokurorit ose policisë gjyqësore mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre'.*

*Së dyti, nuk qëndron konstatimi i bërë: 'Analizim i gabuar i dëshmive të dhëna nga oficerët e policisë gjyqësore, të cilat kanë qenë të qarta duke konfirmuar bashkëfajësinë e dy të pandehurve'.*

*Së treti, nuk qëndron konstatimi se 'Dëshmia e të pandehurit D. P. gjatë gjykimit nuk gjen mbështetje në asnjë provë të administruar dhe si rrjedhojë ky deklaram nuk është i besueshëm dhe është bërë thjesht për të përfituar nga parashikimet ligjor lidhur me kualifikimin juridik të veprës penale'.*

*Së katërti, pasi u njoha me kopjen e akteve që kanë të bëjnë me këtë dosje gjyqësore, konstatoj se në vendimin e saj, nga Gjykata e Apelit Shkodër, nuk evidentohen shkelje të normave urdhëruese procedurale apo mosarsyetim i vendimit gjyqësor. Disponimi i Gjykatës së Apelit Shkodër lidhet me mënyrën e vlerësimit të provave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe vetëm për zgjidhjen e çështjes në themel. Duke iu*

*referuar pjesën arsyetuese të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër rezulton se Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka përsëritur shqyrtimin gjyqësor. Nga leximi i vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër konstatohet se rezultuan të njëjtat fakte, por edhe pse rezultuan të njëjtat fakte, kjo e fundit, mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë vendosi të deklarojë fajtor të pandehurin A. L. që gjykata e shkallës së parë e deklaroi të pafajshëm.*

*Së pesti, qartësisht nga pjesa përshkruese - arsyetuese dhe dispozitivi i këtij vendimi nuk konstatohet asnjë shkelje e dispozitave udhëruese procedurale me pasoja për procesin. Po ashtu, siç mund të konstatohet qartësisht vendimi në fjalë nuk paraqet defekte në mënyrën se si ai është arsyetuar e argumentuar, por shoqërohet nga një vijë logjike dhe interpretative e arsyeshme mbi provat dhe përdorimin e aplikimin e harmonizuar të ligjit procedural penal dhe parimeve të këtij procesi, duke plotësuar në këtë mënyrë rekuizitat e nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, për sa u përket elementeve që vlerësojnë njohuritë ligjore dhe arsyetimin ligjor.*

*Shpreh qëndrimin tim se vendimi nr. \*\*\*, datë 12.12.2016, i dhënë prej trupit gjykues ku kam qenë pjesë, është marrë në përputhje të plotë të ligjit, nuk ka asnjë shkelje procedurale, asnjë favorizim të palëve në gjykim, asnjë shmangie nga praktika ime gjyqësore, fakte këto të cilat mund të ngrinin dyshimin për bazueshmërinë e raportit të DSIK-së. Vendimi është ndryshuar nga Gjykata e Apelit mbi të njëjtat prova, por me një vlerësim të ndryshëm të tyre, ku dhe vetë kjo gjykatë nuk ka qenë e unifikuar për sa kohë një nga gjyqtarët në pakicë ka mbështetur vendimin e trupës gjykuese të shkallës së parë si të bazuar në ligj. Sa më sipër, duke qenë se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit është kryer vetëm mbi bazën e një vlerësimi të ndryshëm të provave, referuar dhe praktikës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit këto gjetje nuk mund të jenë objekt i kontrollit të organeve të rivlerësimit”.*

**22.3 Vendimi nr. \*\*\*, datë 25.7.2019<sup>3</sup>**, me palë kërkuese Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, i kallëzuar shtetasi D. H., kallëzues shtetasi M. K., me objekt “Pushim i procedimit penale nr. \*\*\*, viti 2018, për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve”. Kërkesa e prokurorit datë 14.6.2019 për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, është shqyrtuar nga gjyqtari Arbër Çela, i cili ka vlerësuar se kërkesa e prokurorisë është e paarsyetuar dhe nuk duhet të pranohet, pasi nga ana e organit të akuzës nuk janë marrë në shqyrtim pretendimet e palës kallëzueses. Gjyqtari Arbër Çela ka vendosur në përfundim të gjykimit për mospranimin e kërkesës së prokurorisë dhe kthimin e akteve për kryerjen e hetimeve. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila ka vendosur në datën 17.10.2019 lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Në datën 18.5.2020 prokurori i çështjes ka paraqitur përsëri në gjykatë kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. \*\*. Nga shorti elektronik i datës 21.5.2020 i është caktuar direkt gjyqtarit Arbër Çela, si gjyqtari paraprak i çështjes së parë. Në përfundim të gjykimit, gjyqtari Arbër Çela, me vendimin nr. \*\*, datë 21.9.2020, ka vendosur mospranimin e kërkesës së prokurorisë dhe kthimin e akteve për kryerjen e hetimeve me afat 4-mujor, me arsyetimin se nuk janë kryer të gjitha detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. \*\*, datë 4.6.2018.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, pas përfundimit të hetimeve, ka depozituar në datën 7.6.2021 kërkesën e tretë me objekt “Pushimin e procedimit penal nr. \*\*, viti 2018, për veprën penale ‘falsifikim dokumentesh’”. Gjyqtari Arbër Çela, me vendimin nr. \*\*, datë 12.7.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. \*\*, pasi nuk provohet kryerja e veprës penale “falsifikim dokumentesh”.

Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim nga pala kallëzuese në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila ka vendosur në datën 15.11.2021 lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës

së Shkallës së Parë. Nga verifikimi në faqen e Gjykatës së Lartë rezulton se çështja është rekursuar në datën 22.2.2022 dhe statusi i çështjes është “regjistrim”.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit shpjegon se: “Në lidhje me vendimmarrjet e mia në këtë çështje sqaroj si më poshtë:

- *Vendimi datë 25.7.2019 nga ana ime është vendosur kthimi i çështjes Prokurorisë, pasi kërkesa e organit të akuzës ishte e paarsyetuar. Konkretisht, pavarësisht se nga ana e prokurorit ishin bashkuar dy kallëzime të ndryshme penale nga ana e shtetasve M. K. dhe N. K., nga ana e prokurorit në asnjë moment nuk ishin trajtuar pretendimet e shtetasës N. K., në asnjë moment nuk është përmendur kallëzimi i saj në kërkesë. Pra, nga ana e Prokurorisë kërkohej hedhja poshtë e një kallëzimi të veçanët (kallëzimi i shtetasës K. lidhej me pretendime dhe kërkitime të ndryshme nga kallëzimi i shtetasit K.) dhe, si rrjedhojë, pushimi i një pjese të procedimit penal pa u dhënë asnjë arsye pa u përmendur as si pretendim. Ndaj dhe e kam konsideruar kërkesën e Prokurorisë të paarsyetuar dhe, si rrjedhojë, nuk e kam pranuar.*

*Ky vendim është ankimuar nga ana e prokurorit dhe Gjykata e Apelit Shkodër, në datën 17.10.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, duke e gjetur atë të drejtë dhe të bazuar në ligj.*

- *Vendimi nr. \*\*\*, datë 21.9.2020, nga ana ime është vendosur kthimi i çështjes Prokurorisë pasi prokurori nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga ana e Gjykatës së Apelit Shkodër. Kam arsyetuar se ‘Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.6.2018, ka vendosur: ‘Ndryshimin e vendimit me nr. \*\*\* (\*\*\*)’, datë 25.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Pranimin e ankimit të shtetasve M. K. dhe P. K. Prishjen e vendimit të ‘Mosfillimit të procedimit penal’, datë 15.3.2018, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër në lidhje me kallëzimin nr. \*\*\*, datë 2.3.2018. Urdhërohet Prokuroria të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme në lidhje me këtë kallëzim, sipas detyrave që lihen në pjesën arsyetuese të këtij vendimi’. Nga përmbajtja e pjesës arsyetuese të këtij vendimi rezulton se janë lënë detyra.*

*Rezulton se nga ana e Prokurorisë nuk është zbatuar plotësisht kjo detyrë dhe nuk është ekspertuar fleta e regjistrimit me nr. \*\*\* prot., datë 19.4.1996 dhe po ashtu nota e transkriptimit nr. \*\*\*, datë 26.9.1945. Po ashtu, nga ana e Prokurorisë nuk i është dhënë përgjigje pretendimit se vendimi nr. \*\*\*, i KKKPronave, datë 5.11.1996, është regjistruar në radhorin e pronësisë me nr. \*\*\* prot., datë 19.4.1996, shtatë muaj para se të jepej vendimi dhe kjo gjë nuk është sqaruar nga ana e organit të akuzës... Gjykata çmon se pretendimet e kallëzuesve në lidhje me mosplotësimin e detyrave të lëna nga ana e Gjykatës së Apelit Shkodër janë të bazuara në ligj dhe po ashtu prokurori në seancë nuk paraqiti ndonjë arsye të qenësishme se përse nuk ishin plotësuar të gjitha detyrat e lëna organit të akuzës.*

- *Vendimi nr. \*\*\*, datë 12.7.2021, pasi kam konstatuar se nga ana e Prokurorisë janë zbatuar të gjitha detyrat e lëna nga ana e Gjykatës së Apelit dhe është kryer hetim i gjithanshëm i faktit të pretenduar kam pranuar kërkesën e Prokurorisë për pushimin e këtij procedimi penal. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim nga pala kallëzuese në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila ka vendosur në datën 15.11.2021 lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.*

*Sjell në vëmendje faktin se kjo çështje është bërë objekt hetimi nga ana e Komisionit<sup>32</sup> mbi bazën e denoncimit të kallëzuesve N. K. dhe P. K., në rastin e subjektit të rivlerësimit E. L. (prokurori i çështjes), ku nga ana e Komisionit është analizuar me*

<sup>32</sup>Vendimi nr. 465, datë 28.10.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

*detaje e gjithë vendimmarrja e Gjykatës dhe e Prokurorisë dhe është arritur në konkluzionin se nga ana e prokurorit të çështjes nuk janë zbatuar detyrat e lëna nga ana e Gjykatës së Apelit dhe nuk janë respektuar afatet e lëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

*Në rastin konkret vlerësoj se rezulton qartë se çdo vendimmarrje e imja ka qenë në përputhje me ligjin dhe rregullat procedurale penale dhe se në asnjë moment nuk mund të kishte pasur një vendimmarrje tjetër duke qenë se siç është konstatuar nga ana ime, nga ana e Gjykatës së Apelit, por edhe nga ana e vetë Komisionit (në çështjen e sipërcituar për prokurorin E. L.) organi i akuzës nuk kishte arsyetuar kërkesat e tij, nuk kishte kryer hetim të plotë mbi faktin dhe nuk kishte zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Shkodër”.*

**22.4 Vendimi nr. \*\*\* , datë 27.3.2012<sup>4</sup>**, me palë kërkuese shtetasen L. Gj. (N.), person i interesuar Këshilli i Qarkut Shkodër dhe objekt “Vërtetimi i faktit juridik të vendndodhjes së pronës së shtetasit Rr. N. P. dhe përcaktimin e sipërfaqes së saj”. Nga sistemi informatik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore evidentohet se kjo çështje është depozituar dhe regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër në datën 27.2.2012, me palë kërkuese shtetasin Rr. P., duke iu caktuar për shqyrtim gjyqtarit Arbër Çela. Gjatë seancës përgatitore, datë 5.3.2012, është paraqitur shtetasi M. N., si përfaqësues i trashëgimtarëve të të ndjerit Rr. N. P. për të iniciuar dhe ndjekur këtë gjykim. Ky shtetas ka pretenduar se ka vendosur gabimisht në kërkesëpadi emrin e trashëgimlënësit Rr. N. P., për të cilën është lëshuar Dëshmia e Trashëgimisë në datën 28.5.1999. Po ashtu, ai ka kërkuar edhe ndryshim e objektit të padisë, duke kërkuar vetëm saktësimin e sipërfaqes së pretenduar dhe jo caktimin e vendndodhjes së saj.

Gjyqtari Arbër Çela, me vendim të ndërmjetëm, ka pranuar suksesimin procedural në këtë çështje, duke kryer kalimin procedural të kërkesës nga kërkuesi R. P., që ka ndërruar jetë, tek trashëgimtarja L. Gj., e përfaqësuar nga shtetasi M. N.. Po ashtu, ka pranuar edhe ndryshimin e objektit të kërkesëpadisë, siç u kërkuar gjatë gjykimit, duke vendosur në datën 27.3.2012 njohjen si palë kërkuese shtetasen L. Gj. (N.), pranimin e kërkesës dhe korrigjimin e notës së transkriptit (të datës 15.12.1930) në favor të shtetasit Rr. P., për sa i përket sipërfaqes së pronës së pretenduar, duke vendosur si sipërfaqe 1.735 dynym, siç rezulton nga aktekspertimi.

Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër nga shtetasja L. Gj., e cila më tej ka tërhequr ankimin, duke pretenduar se zgjidhja do të bëhej nëpërmjet akteve administrative. Në përfundim, Gjykata e Apelit Shkodër në datën 26.7.2012 ka vendosur për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e gjykimit të çështjes në rrethanat kur nga ana e palës paditëse L. Gj. është hequr dorë nga gjykimi i padisë.

Nga vlerësimi i dosjes duket se gjyqtari Arbër Çela ka trajtuar në mënyrë favorizuese palët në këtë proces gjyqësor, duke dhënë një vendim në interpretim të gabuar të dispozitave të ligjit.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në lidhje me konstatimet, subjekti shpjegoi se: *“Së pari, duhet të theksohet se realisht kjo kërkesë civile është depozituar dhe nënshkruar nga shtetasi M. N., i cili në bazë të Prokurës së Përgjithshme me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.9.2011, ishte caktuar si përfaqësues i shtetasen L. Gj. (N.). Ky fakt konstatohet lehtësisht nga kërkesa civile, e cila, përveçse është nënshkruar në fund nga shtetasi M. N., në hyrje të saj, tek pjesa ku përcaktohet kërkuesi, është referuar edhe prokura e mësipërme. Në rast se qëllimi do të kishte qenë paraqitja e kërkesës në emër të të ndjerit, atëherë nuk ka arsye citimi i prokurës së përgjithshme apo aq më tepër paraqitja e saj bashkëlidhur kërkesës. Si*

rrjedhojë, rezulton e qartë se në rastin konkret në cilësinë e palës kërkuese është shtetasja L. Gj. (N.), vajza e të ndjerit Rr. P., trashëgimtare ligjore e këtij të fundit.

Së dyti, parashtroj se që në seancën e parë përgatitore të zhvilluar për këtë çështje nga ana ime është relatuar fakti i konstatuar si më sipër, siç kam arsyetuar edhe në vendim, se fillimisht gjykata u vu në lëvizje nga kërkesa me objektin e sipërcituar, por me kërkues shtetasin Rr. N. P.. Ndërkohë, në seancën përgatitore të datës 5.3.2012, në gjykim u paraqit z. M. N., i cili deklaroi se është i pajisur me prokurë nga trashëgimtarët e z. Rr. N. P. për të iniciuar dhe ndjekur këtë gjykim, por gabimisht në kërkesë ai ka vendosur emrin e trashëgimlënësit Rr. N. P., i cili është i vdekur (vërtetuar kjo me dëshminë e trashëgimisë, lëshuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.5.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë). Në këto kushte, z. M. N., duke pretenduar dhe provuar në bazë të Prokurës me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol. se ka tagrat e nevojshëm për të ndjekur këtë çështje para gjykatës, kërkoi kalimin procedural të kërkesës nga kërkuesi, i cili është një shtetas i vdekur tek trashëgimtarja e tij, konkretisht L. Gj. (e cila është e përfaqësuar prej tij).

Së treti, nga ana e Komisionit citohet se: 'Në rastin konkret, pas vënies në dijeni të faktit të vdekjes së palës kërkuese në një periudhë kohore më të hershme se viti 2012, gjyqtari Arbër Çela duhet të dispononte me vendimin për rrëzimin e kërkesë në kushtet kur palës kërkuese i mungonte legjitimitimi për ta paraqitur'. Në lidhje me këtë konstatim çmoj se nuk qëndron, duke qenë se rrëzimi i kërkesës apo kërkesëpadisë për mungesë të legjitimitetit mund të bëhet vetëm në përfundim të gjykimit (me vendim përfundimtar) dhe kur mungon legjitimiteti substancial, real. Legjitimitimi real i takon shqyrtimit gjyqësor të themelit të çështjes, për të cilin gjykata shprehet në vendimin përfundimtar. Si rrjedhojë, duke qenë se në rastin konkret nuk jam ndodhur përpara mungesës së legjitimitetit substancial, nuk mund të vendosja rrëzimin e kërkesës.

Së katërti, rezulton se shtetasja L. Gj., duke mos qenë dakord me vendimin e marrë nga ana ime në përfundim të gjykimit, pra vendimit nr. \*\*\*, datë 27.3.2012, ka paraqitur ankim pranë Gjykatës së Apelit Shkodër. Ky ankim është nënshkruar nga shtetasi M. N., në cilësinë e përfaqësuesit të shtetases L. Gj. Gjykata e Apelit Shkodër e ka marrë në shqyrtim këtë ankim dhe në përfundim, me anë të vendimit nr. \*\*\*, datë 26.7.2012, ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 27.3.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe pushimin e gjykimit të çështjes që i përket kërkueses L. Gj. (N.). Gjykata e Apelit Shkodër e ka marrë këtë vendim në përputhje me nenin 201 të Kodit të Procedurës Civile, duke qenë se kërkuesja ka hequr dorë nga gjykimi kërkesës. Si rrjedhojë, rezulton se Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka konstatuar asnjë shkelje procedurale dhe aq më tepër mungesë të legjitimitetit. Në rast se do kishte konstatuar një fakt të tillë, Gjykata e Apelit do të kishte vendosur mospranim ankimi, në bazë të nenit 450/1/ç të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se vendoset mospranimi i ankimit kur është bërë nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim. Pra, konstatohet se Gjykata e Apelit Shkodër e ka vlerësuar njëjtë si unë.

Siç kam cituar edhe në pikën e mësipërme, në lidhje me konstatimet e bëra në raport, Gjykata e Apelit Shkodër nuk ka gjetur asnjë shkelje procedurale, që mund të prezumonte favorizim nga ana ime. Madje konstatohet se pala kërkuese L. Gj. ka hequr dorë nga gjykimi i padisë, duke pretenduar se do ta zgjidhë çështjen në rrugë administrative. Me këtë qëndrim të palës kërkuese, mbështetur edhe në vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit, konsiderohet se kërkesa nuk është paraqitur dhe nuk ka ardhur asnjë pasojë nga vendimi im, duke u rikthyer e gjithë situata në gjendjen fillestare, pra para se të vihej në lëvizje gjykata.

Së gjashti, referuar natyrës së gjykimit, gjykimi për vërtetimin juridik të fakteve është një gjykim gracioz pa palë kundërshtarë e, për rrjedhojë, vërtetimi gjyqësor i faktit nuk synon të zgjidhë një konflikt apo mosmarrëveshje, të njohë apo jo një të drejtë, por

*thjesht synon të formësojë apo të ribëjë gjyqësisht provën, shkresën, dokumentin apo aktin e munguar që pasqyron faktin juridik, i cili passjell lindjen, ndryshimin apo shuarjen e një të drejte pasurore apo personale jopasurore të kërkuarit. Pra, gjykimi i posaçëm për vërtetimin gjyqësor të faktit nuk mund të shërbejë si një rrugë për të mënjanuar rrugën e zakonshme kontencioze të zgjidhjes së konfliktit. Aq më tepër që, duke mbajtur parasysh se vendimi gjyqësor i dhënë është i natyrës deklarative, ai nuk është i ekzekutueshëm, pra nuk është i detyrueshëm për të tretët, me të cilët kërkuari i vërtetimit të faktit mendon se ka një çështje a konflikt për të zgjidhur (shihni nenin 392 të Kodit të Procedurës të Civile). Gjykata thjesht deklaroi se ajo e konsideron një fakt të dhënë juridik si të vërtetuar, duke lehtësuar në këtë mënyrë realizimin eventual të të drejtave të ligjshme të kërkuarit. Në fund të fundit, të drejtat dhe detyrimet që lindin nga ai fakt juridik i vërtetuar nuk çmohen e vendosen nga gjykata në atë gjykim. Ato zgjidhen nëpërmjet rrugëve të tjera, përfshirë atë të ngritjes së padive në gjykatë me palë kundërshtarë (vendim nr. \*\*\*, datë 18.12.2009, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).*

*Sa më sipër, vlerësoj se vendimi i marrë nga ana ime ka qenë në përputhje me ligjin procedural civil, faktet dhe rrethanat që kanë rezultuar gjatë gjykimit, si dhe provat e administruara. Nuk kam kryer asnjë veprim apo marrë ndonjë vendim që mund të ketë pasur për qëllim favorizimin e palëve ndërgjyqëse. Si përfundim, vlerësoj se kam respektuar të gjitha dispozitat materiale dhe procedurale për çështjen në gjykim dhe kam dhënë një vendim të bazuar në ligj e në prova”.*

**22.5 Çështja me palë të pandehur shtetasin A. A.** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.6.2022, ka përcjellë informacionin dhe kopje të vendimeve gjyqësore lidhur me çështjen penale nr. \*\*\* ndaj shtetasit A. A., nga ku rezultoi si vijon: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka përcjellë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. \*\*\*, me palë të pandehur shtetasin A. A., të akuzuar për kryerjen e veprave penale “vrasje me dashje” mbetur në tentativë dhe “mbajtje pa leje i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”. Kjo çështje është regjistruar në datën 19.12.2018 dhe fillimisht nga shorti i datës 20.12.2018 i është caktuar gjyqtari B. S. Për shkak të transferimit të këtij gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, kjo dosje është rishortuar më 27.12.2018, duke u caktuar gjyqtari Arbër Çela. Në përfundim të gjykimit, gjyqtari Arbër Çela, me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.2.2019, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së prokurorisë, kthimin e akteve prokurorit për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “vrasje me dashje e mbetur në tentativë” në “plagosje e lehtë me dashje”. Ky vendim është marrë në mungesë të të pandehurit. Kundër vendimit nr. \*\*\* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është paraqitur ankimi nga Prokuroria në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku kjo e fundit ka konstatuar se:

- *Vendimi i gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket kalimit të akteve prokurorisë, duhet lënë në fuqi vetëm për plotësim hetimi. Aktet nuk i duhen kthyer prokurorisë për riformulim akuze.*
- *Gjykata e Shkallës së Parë është shprehur vetëm për ndryshimin e akuzës së vrasjes së mbetur në tentativë, por nuk është shprehur lidhur me veprën penale “mbajtje pa leje e armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”.*
- *Në dispozitivin e vendimit gjyqtari është shprehur mbi ndalimin e ushtrimit të së drejtës së ankimit mbi këtë vendimmarrje. Dispozita e posaçme ligjore së cilës i referohet gjyqtari Arbër Çela në arsyetimin e vendimit nuk përmban në vetvete asnjë përkufizim dhe nuk shprehet për të drejtën e ankimit. Për rrjedhojë nuk mund të arrihej në përfundimin se kundër vendimit nuk lejohet ankimi.*

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.3.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit me disa ndryshime, duke urdhëruar Prokurorinë të kryejë hetime brenda 60 ditëve.

Pas përfundimit të hetimeve sipas detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit Shkodër, është depozituar në datën 11.2.2020 nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, kërkesë për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2018, në ngarkim të të pandehurit A. A., akuzuar për kryerjen e veprave penale “plagosje e rëndë me dashje” dhe “mbajtje pa leje i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”. Kjo çështje i ka kaluar gjyqtarit Arbër Çela, i cili, me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.7.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin për gjykimin të procedimit penal nr. \*\*\*.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka përcjellë fashikull për procedimin penal nr. \*\*\* ndaj shtetasit A. A. Nga vlerësimi i dosjes ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, gjyqtari H. S., me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.5.2018, ka vendosur masën e sigurisë “arrest me burg” për të pandehurin A. A., në mungesë. Me kërkesë të Prokurorisë, në datën 25.9.2018, me vendimin nr. \*\*\*, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, gjyqtari H. S. ka vendosur deklaram ikje për shtetasin nën hetim A. A. Pas dorëzimit vullnetar të të pandehurit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.2.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur verifikimin e kushteve për masën e sigurimit “arrest me burg” dhe vijimin e zbatimit të kësaj mase.

Me kërkesë të të pandehurit A. A., në mungesë, është kërkuar zëvendësimi i masës së sigurimit nga “arrest me burg” në një masë më të butë “arrest në shtëpi dhe garanci pasurore”. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga gjyqtari Arbër Çela, i cili, me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.7.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi dhe garanci pasurore”.

Nga analizimi i akteve të gjyqtarit Arbër Çela në dosje, rezulton se lidhur me kërkesën e prokurorisë me objekt “Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. \*\*\*, në ngarkim të shtetasit A. A. për veprat penale ‘vrasje me dashje’ mbetur në tentativë dhe ‘mbajtje pa leje e armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit’”, gjyqtari Arbër Çela ka argumentuar në vendimin nr. \*\*\* të datës 21.2.2019 se nga administrimi i akteve provuese arrihet në përfundimin se organi i akuzë nuk i ka dhënë faktit penal një përcaktim të saktë ligjor, duke e cilësuar në mënyrë të gabuar. Gjyqtari Arbër Çela ka vendosur për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, në “plagosje të lehtë me dashje” në ngarkim të shtetasit A. A. Gjyqtari ka përdorur si referencë ligjore për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale pikën 3 të nenit 332/dh të Kodit të Procedurës Penale.

Nga verifikimi në raport me legjislacionin në fuqi rezulton se vlerësimi i gjyqtarit lidhur me ndryshimin e cilësimit juridik është bërë në referim të gabuar ligjor, pasi kjo procedurë është parashikuar në pikën 3 të nenit 332/d të Kodit të Procedurës Penale (e cila mund të jetë edhe një lapsus nga gjyqtari). Gjyqtari nuk është shprehur në vendimin përfundimtar lidhur me veprën penale “mbajtje pa leje e armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”, e cila duket se është harruar me dashje.

Vendimi i gjyqtarit Arbër Çela për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale duket se është i gabuar, pasi në rrethanat kur nga hetimet e prokurorisë nuk dilte i qartë fakti penal, gjyqtari duhet t'i kthente aktet për plotësim hetimi dhe jo citim të veprës penale, e cila është detyrë e organit të akuzës në varësi të rrethanave të rezultuara nga hetimi.

Duket se gjyqtari është shprehur në dispozitiv mbi ndalimin e ushtrimit të së drejtës së ankimit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Rezulton se gjyqtari Arbër Çela është shprehur edhe për kërkesën e prokurorisë për gjykimin e çështjes edhe për masën e sigurisë për këtë të pandehur.

Në përfundim të sa më sipër, duket se gjyqtari Arbër Çela ka marrë vendim në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal. Duket se gjyqtari ka favorizuar pozitën e të pandehurit gjatë vendimmarrjeve të tij.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se: *“Konstatimi i parë: nga ana e Komisionit për këtë çështje është pretenduar se: ‘Duket se gjyqtari Arbër Çela ka marrë vendim në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal. Duket se vlerësimi i mungesës së ushtrimit të së drejtës së ankimit është një shkelje procedurale, duke cenuar të drejtën e palëve për një proces të rregullt ligjor dhe kjo shkelje afekton gjithashtu indikatorët e përcaktuar në pikën 2 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016 lidhur me aspektin e njohurive ligjore dhe aftësinë e përgjithshme të gjyqtarit për të interpretuar ligjin’.*

*Në lidhje me këtë pikë theksoj se nga ana ime janë zbatuar në mënyrë strikte rregullat procedurale penale dhe po ashtu është arsyetuar përse në rastin konkret nuk lejohet e drejta e ankimit ndaj vendimit gjyqësor. Në vendim kam arsyetuar se: ‘Në lidhje me të drejtën e ankimit gjykata i referohet nenit 407 të Kodit të Procedurës Penale, ‘Rastet dhe mjetet e ankimit’, i cili parashikon se ‘Ligji cakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhrat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e ankimit’. Në rastin konkret, nga ana e ligjvënësit nuk është përcaktuar e drejta e ankimit në rastin e kthimit të çështjes për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, siç është përcaktuar për rastet e tjera të disponimit të gjykatës’.*

*Në rastin konkret kam zbatuar ligjin, por edhe praktikën e gjykatave të tjera, të cilat kanë qenë konsekuente në interpretimin e faktit se ndaj këtyre vendimeve nuk lejohet e drejta e ankimit. (p.sh. vendimi nr. \*\*\*, datë 30.5.2018, i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimi nr. \*\*\*, datë 9.4.2019, i Gjykatës së Apelit Durrës). Po ashtu theksoj se arsyetimi i dhënë nga ana ime përputhet edhe me praktikën e Gjykatës së Lartë. Kështu, në vendimin nr. \*\*\*, datë 19.7.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, arsyetohet se: Në lidhje me pretendimin se Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e saj ka cenuar institutin e ankimit dhe për pasojë ka bërë edhe cenimin e parimit të një procesi të drejtë gjyqësor të ngritur nga kërkuesit në rekurs, Kolegji vlerëson të sjellë në vëmendje se Kodi i Procedurës Penale në titullin VIII, ‘Ankimet’, kreu I, ‘Rregullat e Përgjithshme’, ka përcaktuar në nenin 407 rastet dhe mjetet e ankimit. Pika 1 e nenit 407 përcakton rregullin ‘Ligji cakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhrat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjete e ankimit’. Në këtë formulim evidentohet se e drejta e ankimit udhëhiqet nga parimi i taksativitetit, që e drejta e ankimit duhet të njihet nga ligji në mënyrë të shprehur. Për pasojë, rregullat e ankimit duhet t’i referohen nenit 332/ç me titull ‘Vendimi për plotësimin e hetimeve’, i cili parashikon se: ‘1. Kur çmon se hetimet paraprake nuk janë të plota, gjykata urdhëron plotësimin e tyre, duke përcaktuar drejtimin dhe, kur është rasti, edhe aktet që duhet të kryhen. Kur konstaton akte të pavlefshme ose prova të papërdorshme, gjykata i deklaron ato me vendim dhe, kur është e mundur, urdhëron përsëritjen e tyre. Gjykata cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë dhe datën e seancës së re. 2. Vendimi i njoftohet drejtuesit të prokurorisë’.*

*Kolegji vlerëson se ankimi si mjet dhe e drejtë për të kundërshtuar një vendim të gjykatës më të ulët në gjykatën më të lartë duhet të jetë parashikuar në ligj. Qëndrimi që mban kërkuesi në rekursin e tij se e drejta e ankimit lejohet pasi ligji nuk është shprehur për ndalimin e ushtrimit të kësaj të drejte, nuk qëndron dhe nuk është i pabazuar, ku taksativisht ai ndalohet kur çështja dërgohet për më tepër në gjykim. E vetmja mundësi që ligji jep për të bërë ankim në këtë fazë të gjykimit është në lidhje me vendimmarrjen për pushimin e çështjes, pasi në një formë çështja zgjidhet në themel dhe palët nëse kanë pretendime kanë të drejtën për të ankimuar vendimin e pushimit. Kolegji e gjen të pabazuar edhe pretendimin se çështja duhet të kalojë për njehsim të*



praktikës gjyqësore, pasi nuk vërehen në praktikat e vendimmarrjes së gjykatave, kundërshtime për interpretimin e këtij momenti procedural.

Gjykata e Lartë ka sqaruar qartë se në cilat raste lejohet ankimi ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake, madje vetë Gjykata e Lartë nuk ka parë as zbatime të ndryshme të këtij parimi juridik, teksa thekson se: 'Kolegji e gjen të pabazuar edhe pretendimin se çështja duhet të kalojë për njehsim të praktikës gjyqësore, pasi nuk vërehen në praktikat e vendimmarrjes së gjykatave kundërshtime për interpretimin e këtij momenti procedural'.

Po ashtu sjell në vëmendje faktin se në rastin konkret vendosja apo jo e të drejtës së ankimit është e karakterit informues kryesisht për palën që nuk ka njohuritë ligjore. Në rastin konkret, nga ana e prokurorit është vlerësuar vetë nëse duhet të paraqiste ankim apo jo dhe parashikimi i vendosur nga unë në vendim nuk e ka penguar këtë të fundit të ushtrojë të drejtat e tij dhe, si rrjedhojë, nuk ka sjellë asnjë pasojë ligjore.

Konstatimi i dytë: sipas Komisionit 'Vendimi i gjyqtarit Arbër Çela për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale duket se është i gabuar, pasi në rrethanat kur nga hetimet e prokurorisë nuk dilte i qartë fakti penal, gjyqtari duhet t'i kthente aktet për plotësim hetimi dhe jo citim të veprës penale e cila është detyrë e organit të akuzës në varësi të rrethanave të rezultuara nga hetimi'.

Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit nuk jam dakord, pasi nga Gjykata e Apelit nuk janë gjetur shkelje procedurale në gjykim, madje Gjykata e Apelit e ka gjetur të drejtë vendimin tim për kthimin e çështjes prokurorit dhe po ashtu Gjykata e Apelit është bashkuar me qëndrimin tim për mungesë të elementeve të veprës penale 'vrasje me dashje' e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 76-22 i Kodit Penal. Ndërkohë që divergjencia midis vendimmarrjes së dy gjykatave lidhet me vlerën provuese të provave, konkretisht aktekspertimit mjeko-ligjor.

Konstatimi i tretë: sipas Komisionit vlerësohet se 'Nga verifikimi në raport me legjislacionin në fuqi rezulton se vlerësimi i gjyqtarit lidhur me ndryshimin e cilësimit juridik është bërë në referim të gabuar ligjor, pasi kjo procedurë është parashikuar në pikën 3 të nenit 332/d të Kodit të Procedurës Penale (e cila mund të jetë edhe një lapsus nga gjyqtari). Por gjyqtari ndërkohë nuk është shprehur në vendimin përfundimtar lidhur me veprën penale 'mbajtje pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit', e cila duket se është harruar me dashje'.

Në lidhje me pjesën e parë të konstatimit është lapsus germa 'dh' është shënuar 'd'. Ndërkohë që konstatimi se nuk jam shprehur në vendim përfundimtar për veprën penale 'mbajtje pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit', nuk qëndron.

Në vendimin jam shprehur se: 'Në konkluzion të këtij arsytimi, pas shqyrtimit të akteve të mësipërme provuese, gjykata konkludon së i pandehuri ka konsumuar tërësisht veprat penale 'plagosje e lehtë me dashje' dhe 'mbajtje pa leje dhe prodhim të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit', parashikuar nga nenet 76-22 dhe 278/1 të Kodit Penal'.

Rezulton e qartë që unë kam qenë dakord me akuzën e ngritur nga ana e prokurorisë ndaj të pandehurit për veprën penale 'mbajtja pa leje dhe prodhim të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit', parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal, madje kam shprehur qartë në arsytimin e vendimit se i pandehuri e ka kryer këtë vepër penale. Ndër të tjera, akuza për këtë vepër është pranuar edhe nga mbrojtja dhe nuk ka pasur asnjë kontestim apo përpjekje të mbrojtjes për t'u shmangur nga kjo akuzë.

Në dispozitiv kur kam kthyer procedimin penal i kam caktuar detyrë prokurorisë vetëm në lidhje me akuzën 'vrasje me dashje', e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 76-22 i Kodit Penal, pra duke e marrë të provuar dhe të hetuar saktë akuzën e kryerjes

së veprës penale 'mbajtja pa leje dhe prodhim të armëve, armëve shpërthyes dhe municionit', parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal. Ky vendim gjen mbështetje edhe në parashikimin që bën vetë Kodi i Procedurës Penale në nenin 332/d/3.

Më tej rezulton se pas kryerjes së veprimeve hetimore nga ana e prokurorisë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.7.2020, kam vendosur:

- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dërgimin e çështjes në gjyq për të pandehurin A. L., i akuzuar për kryerjen e veprave penale 'plagosje e rëndë me dashje' dhe 'mbajtje pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit', parashikuar nga nenet 88/1 dhe 278/1 të Kodit Penal.
- Dërgimin e çështjes për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, bashkëngjitur aktet e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2018.
- Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

Në këto kushte kundërshtoj faktin se unë kam harruar pa përmendur veprën penale të cituar nga ana e Komisionit. Po ashtu, në tërësi, në asnjë moment nuk rezulton që unë mund të kem favorizuar të pandehurin gjatë vendimmarrjes time.

Konstatimi i katërt: sipas Komisionit, 'Duket i dyshimtë rishortimi i vetëm kësaj çështjeje më 27.12.2018, pas shortimit të saj vetëm një javë më parë (20.12.2018 i është caktuar gjyqtarit B. S.). Na informoni sa çështje janë shortuar në datën 27.12.2018 (referuar Urdhrit nr. \*\*\*, të Kryetarit).

Në lidhje me këtë konstatim shprehem se:

- i. Shortimi dhe monitorimi i çështjeve kryhet nga Kryetari i Gjykatës dhe Kancelari, ku unë në cilësinë e gjyqtarit nuk kam pasur asnjë akses. Në periudhën konkrete Kryetar i Gjykatës ka qenë z. A. Z.
- ii. Kërkesa e prokurorisë më sipërcituar është depozituar nga kjo e fundit në datën 17.12.2018, është regjistruar dhe i është nënshtruar shortit elektronik të radhës, datë 20.12.2018, duke i kaluar për gjykim gjyqtarit B. S. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.12.2018, ka vendosur transferimin e përkohshëm të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë.
- iii. Në të tilla kushte është realizuar rishortimi i çështjeve të këtij gjyqtari (B. S.), sipas listës së dosjeve të dorëzuara nga ana e tij dhe në zbatim të Urdhrit nr. \*\*\*, datë 24.12.2018, të Kryetarit të Gjykatës, z. A. Z. Në bazë të këtij urdhri, në datën 27.12.2018, pas rishortimit elektronik të çështjeve të gjyqtarit B. S., përfshirë edhe çështja në fjalë, kjo e fundit i ka kaluar për gjykim gjyqtarit Arbër Çela. (bashkëlidhur gjeni vendimin RIV të veprimeve me dosjen dhe kopje të procesverbalit të dorëzimit të dosjeve të gjyqtarit B. S. dhe Urdhrit nr. \*\*\*, datë 24.12.2018, të Kryetarit të Gjykatës për rishortimin e tyre).
- iv. Në lidhje me pyetjen se sa dosje janë shortuar në datën 27 dhjetor 2018, ju bashkëngjis si provë fletën e shortit të asaj dite, ku rezultojnë të shortuara mbi 88 dosje, në të cilat përfshihen dhe dosjet e dorëzuara nga ana e gjyqtarit B. S.

Në këto kushte dyshimi i Komisionit për rishortimin e kësaj çështjeje në datën 27 dhjetor 2018 nuk qëndron, pasi në atë datë janë shortuar bashkë me shortin e zakonshëm të gjitha dosjet e gjyqtarit B. S., për më tepër që hedhja në short e dosjeve nuk ka qenë kompetencë e imja.

Çdo kërkesë e paraqitur në kuadër dhe për llogari të procedimit penal objekt shqyrtimi gjykohen nga i njëjti gjyqtar. Kjo parashikohet në nenin 260/4 të Kodit të Procedurës Penale, ku thuhet se: 'Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen

*aktet, brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj. Kur është rasti, gjykata vendos edhe kryesisht revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit gjatë marrjes në pyetje të personit të arrestuar, sipas nenit 248 të këtij Kodi, në rastet e parashikuara nga paragrafi 6 i nenit 246 të tij, gjatë procedimit për sigurimin e provës, gjatë seancës paraprake ose gjatë gjykimit’.*

*Po ashtu vendimmarrja ime në lidhje me zëvendësimin e masës së sigurimit ndaj të pandehurit është arsyetuar në mënyrë të plotë dhe është në zbatim të ligjit. Po ashtu kjo vendimmarrje është pranuar edhe nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër dhe Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur ‘Mospranimin e ankimit ndaj vendimit nr. \*\*\*, datë 9.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër’.*

*Si përfundim, vlerësoj se kam respektuar të gjitha dispozitat materiale dhe procedurale për çështjen në gjykim dhe kam dhënë një vendim të bazuar në ligj e në prova”.*

**22.6 Vendimi nr.\*\*\*, datë 12.12.2019**, me palë kërkuese Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në ngarkim të të pandehurit V. L., me objekt “Dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. \*\*\* në ngarkim të të pandehurit V. L. për kryerjen e veprës penale ‘plagosje e rëndë me dashje’ dhe pushimin e procedimit penal për kryerjen e veprës penale ‘prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve të ftohta’”. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka përcjellë në datën 15.11.2019 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq në ngarkim të të pandehurit V. L., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “plagosje e rëndë me dashje” në dëm të shtetasit A. N. dhe pushimin e pjeshëm të hetimit për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve të ftohta”. Kjo çështje është gjykuar nga gjyqtari Arbër Çela.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në lidhje me këtë rast pavarësisht se nga ana e DSIK është referuar si rast korrupsioni, siç konstatohet lehtësisht, vendimmarrja ime ka qënë për pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe dërgimin e çështjes në gjykim për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”. Kundër këtij vendimi nuk është paraqitur ankim dhe ai ka marrë formë të prerë më datë 08.01.2020. Themeli i kësaj çështje është gjykuar nga një gjyqtar tjetër.

**22.7 Vendimi<sup>7</sup> nr. \*\*\*, datë 4.11.2020**, me palë kërkuese Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Kjo çështje është gjykuar në trup gjykues, ku kryesues ka qënë gjyqtari T. S. dhe gjyqtari Arbër Çela ka qënë në cilësinë e anëtarit. Prokuroria ka kërkuar deklarin fajtor të të pandehurit S. D. për kryerjen e veprës penale “vrasje me dashje” mbetur në tentativë dhe dënimin me 10 vjet e 6 muaj burgim, si dhe deklarin fajtor për kryerjen e veprës penale “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” dhe dënimin e tij me 3 vjet e 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal prokurori ka kërkuar bashkimin e dënimeve dhe dënimin e tij përfundimisht me 11 vjet e 6 muaj burgim.

Trupi gjykues ka vendosur në përfundim të gjykimit deklarin fajtor të të pandehurit S. D. për veprën penale “vrasje me dashje”, mbetur në tentativë dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim, si dhe ka vendosur deklarin fajtor për veprën penale “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” dhe dënimin me 3 vjet e 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal i pandehuri S. D. është dënuar me 10 vjet e 6 muaj burgim.

Vendimi është ankimuar nga i pandehuri S. D. në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila ka vendosur në datën 11.6.2021 lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë rezulton se kjo çështje është rekursuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër në datën 15.9.2021 dhe statusi aktual është në “regjistrim”.

Nga verifikimi rezulton se për veprën penale “vrasje me dashje”, mbetur në tentativë, objekt gjykimi parashikohet në nenin 76 të Kodit Penal dënimi me burgim nga 10 deri në 20 vjet. Ndërsa për veprën penale “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” në nenin 278/1 parashikohet dënim me burgim nga 3 deri në 7 vjet. Prokurori, në pretencën e tij, ka kërkuar minimumin e masës së dënimit me burgim.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Në çështjen konkrete nuk konstatohet as nga Komisioni ndonjë indikacion për shkelje procedurale apo të ligjit material. I pandehuri është gjendur fajtor nga ana e Gjykatës. Vendimi është ankimuar vetëm nga ana e të pandehurit dhe Gjykata e Apelit e ka gjetur vendimarrjen të drejtë e të bazuar në ligj duke e lënë vendimin në fuqi.

**22.8 Vendimi<sup>8</sup> nr. \*\*\*, datë 9.3.2020**, me palë kërkuese Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt “Pushimin e procedimit penale nr. \*\*\*, viti 2017, në ngarkim të shtetasit G. K. për veprat penale ‘korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike’ dhe ‘korrupsion aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike’”. Kjo çështje është gjykuar nga Arbër Çela në cilësinë e gjyqtarit paraprak, i cili në përfundim të gjykimit ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe pushimin e procedimit penal. Kundër këtij vendimi nuk është paraqitur ankim, duke marrë formë të prerë në datën 24.3.2020.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit shpjegon se: *“Në rastin konkret, vlerësoj se vendimi i dhënë prej meje duke pranuar kërkesën e prokurorisë për ‘Pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2017, në ngarkim të shtetasit G. K.’ është në zbatim të ligjit dhe asnjë vendimarrje tjetër nuk mund të merrej në rastin konkret. Sipas faktit të provuar ka rezultuar se:*

- *Prokuroria kishte regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2017, në ngarkim të shtetasit G. K.*
- *Prokuroria i ka kërkuar gjyqtarës A. Ll. të miratojë kërkesën për përgjimin e disa numrave telefonikë. Kjo kërkesë nuk është pranuar nga gjykata e shkallës së parë, duke arsyetuar se nuk ka asnjë provë për përfshirjen e të hetuarit në veprime korruptive.*
- *Vendimi nr. \*\*\*, datë 20.6.2019, është ankimuar nga prokurori dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.6.2019, ka lënë në fuqi vendimin nr. \*\*\*, datë 20.6.2019.*
- *Pas këtyre vendimarrjeve nga ana e prokurorisë për 1 vit nuk është kryer asnjë veprim hetimor dhe nga ana e prokurorit është kërkuar pushimi i procedimit penal, pasi nuk ka asnjë provë për të provuar faktin për të cilin është regjistruar procedimi. Prokurori shprehet se: ‘...nuk mund të kryhen veprime të tjera hetimore pasi në pothuajse 1 (një) vit hetim nuk është bërë i mundur vërtetimi i akuzës në kuadër të këtij procedimi penal dhe hetimet nuk mund të vazhdojnë më tej për ta provuar këtë vepër penale. Siç është shprehur edhe gjykata e dy shkallëve, të dhënat që janë referuar nga policia janë pas një prove për të justifikuar një dyshim të arsyeshëm dhe se ndoshta policia duhej që gjatë punës operativo-gjurmuese të kishte përdorur metoda operative pune për të fiksuar ndonjë provë, qoftë edhe me përgjime parandaluese, që ndoshta do ta kishte çuar tek flagranca’.*
- *Arsyetimi i prokurorisë është pranuar nga ana ime, duke u shprehur në vendim se: ‘Gjykata bashkohet me qëndrimin e prokurorisë se nisur nga natyra e veprës penale objekt hetimi, pra ajo e ‘korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike’, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, veprimet hetimore duhet të karakterizohen nga sekretit dhe po ashtu menjëhershmeria e kryerjes së tyre duke*

*synuar mundësisht kapjen në gjendje flagrance të autorëve të dyshuar. Ndërkohë, në gjendjen e tanishme mbi 1 vit pas regjistrimit të procedimit me të drejtë organi i akuzës është në pamundësi për të kryer ndonjë veprim hetimor që të mundësojë përcaktimin e përgjegjësive penale të personave të proceduar’.*

**23.** Subjekti i rivlerësimit i kërkuar Komisionit që të mos marrë në konsideratë këto të dhëna në vlerësimin e kontrollit të figurës, pasi konstatimet tejkalojnë objektin e veprimtarisë së Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, sipas parashikimeve të neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë këndvështrim, Komisioni e gjen të drejtë këtë kërkesë e vlerëson se konstatimet nuk mund të referohen në vlerësimin e kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit Arbër Çela, por elemente të këtyre çështjeve duhet të vlerësohen në kuadër të vlerësimit tërësor dhe atij të cenimit të besimit gjatë ushtrimit të detyrës.

**24.** Komisioni kërkoi informacion Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin e rivlerësimit, e cila, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2021, ka përcjellë informacion nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, nga ku nuk rezulton të ketë çështje penale apo kallëzime penale të filluara ndaj subjektit të rivlerësimit, apo ndonjë e dhënë tjetër.

### **Konkluzione për kriterin e vlerësimit të kontrollit të figurës**

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Kontakti i deklaruar prej tij nuk u gjet në kushtet e përcaktuara në kreun V të ligjit nr.84/2016 dhe as i mjaftueshëm për të arritur në një konkluzion vlerësues negativ për këtë subjekt.

Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Arbër Çela ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**25.** Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit, ka dërguar një raport për vlerësimin profesional të subjektit Arbër Çela, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**26.** Nga analiza e gjetjeve në pesë dosjet e përzgjedhura me short dhe tri vendimet gjyqësore të paraqitura nga subjekti ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, gjyqtari Arbër Çela, shfaq aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtari Arbër Çela manifeston njohuritë e duhura në drejtim të cilësimit juridik të veprës penale. Në të drejtën penale, gjyqtari njuh dhe zbaton alternativat e dënimit me burgim, si dhe aplikon uljen e dënimit për të pandehurin e mitur, respekton të drejtën e të pandehurit për të pasur avokat mbrojtës në gjykim, aplikon kur është rasti gjykimin e posaçëm, gjykimin e shkurtuar, ka njohuri të mira në caktimin e masave të sigurimit personal, etj.

Subjekti i rivlerësimit Arbër Çela ka aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të arsyetuara prej tij janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, i jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjykimit, duke treguar se gjyqtari ka qenë i vëmendshëm ndaj kërkesave të tyre. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Vendimet e ndërmjetme shoqërohen gjithnjë me referencë ligjore.

**27.** Nga analiza e të dhënave statistikore konstatohet se subjekti i rivlerësimit Arbër Çela është eficient dhe efektiv në çështjet që ka shqyrtuar. Respektimi i kohës në gjykim përbën një aspekt të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor.

**28.** Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Arbër Çela janë paraqitur 2 ankesa në vitin 2014 pranë Inspektoratit të KLD-së.

- i) 1 ankesë e vitit 2014 është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se është ankesë e përsëritu;
- ii) 1 ankesë e vitit 2014 është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe në përfundim është sugjeruar për gjyqtarin “tërheqje vëmendje me shkrim”.

**28.1** Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Arbër Çela, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

**28.2** Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime lidhur me ankesën e vitit 2014, konstatimet për zvarritje të gjykimit dhe masat konkrete të marra për këtë rast.

**28.3** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nuk është njoftuar dhe nuk ka pasur asnjë dijeni në lidhje me këtë vendimmarrje. Pas njohjes me këtë konstatim subjekti është vënë në lëvizje duke kërkuar informacion pranë KLGJ-së, ku është njohur me praktikën e ankimit të paraqitur në vitin 2014, që i përket ankueses R. Q., për të cilën ka rezultuar se nuk ka asnjë vendimmarrje të ish-KLD-së. Sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezulton se: “Ankesa me nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2014, me ankues R. Q., është dërguar për trajtim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

**28.4** Në lidhje me thelbin e çështjes, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “Shtetasja R. Q. ka qenë palë në një gjykim kërkesë penale ku gjyqtar i çështjes ka qenë gjyqtar E. B.. Kjo shtetase ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit E. B. nga gjykimi. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit është marrë në shqyrtim nga gjyqtari A. Y., i cili ka vendosur ‘Pranimin e kërkesës. Përjashtimin e gjyqtarit E. B. nga gjykimi i kërkesës’.

Më rezulton se gjyqtari E. B. ka çmuar të paraqesë rekurs ndaj vendimmarrjes së gjyqtarit A. Y. për përjashtimin e tij nga kjo çështje, duke përdorur si bazë ligjore nenin 22 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikonte (në atë kohë para ndryshimeve ligjore) se:

*'1. Kur kërkesa e përjashtimit është bërë nga ai që nuk e ka pasur këtë të drejtë ose duke mos respektuar afatet ose format e parashikuara nga neni 19 ose kur shkaqet e paraqitura janë të bazuara në ligj, gjykata që shqyrton ankimin e shpall atë të papranueshëm me vendim.*

*2. Gjkata mund të pezullojë përkohësisht çdo veprimtari procedurale ose ta kufizojë atë në kryerjen e veprimeve të ngutshme.*

*3. Gjkata, pasi merr të dhënat e nevojshme, vendos për kërkesën e përjashtimit.*

*4. Vendimi i dhënë në bazë të paragrafëve të mësipërm i njoftohet gjyqtarit, për të cilin është kërkuar përjashtimi, prokurorit, të pandehurit dhe palëve private. Kundër tij mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Kasacionit'.*

*Si rregull çdo ankim ndaj një vendimi gjyqësor përcillet bashkë me dosjen e vendimit të ankimuar pranë Gjykatës së Apelit apo Gjykatës së Lartë. Në këtë rast kam pasur qëndrimin se ndaj vendimit të Gjykatës për përjashtim, gjyqtari i përjashtuar nuk ka të drejtë të paraqesë ankim apo rekurs, nisur nga fakti se gjyqtari nuk është palë në asnjë gjykim. Megjithatë, duke mos pasur kompetenca si kryetar për të vendosur refuzimin e ankimeve të paraqitura, kam zbatuar praktikën e Gjykatës që ankimet e diskutueshme i kalonte për vlerësim gjyqtarit të gatshëm për të vlerësuar ai nëse duhet lejuar ankimi apo jo.*

*Gjyqtari i gatshëm, me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.6.2014, ka vlerësuar se në këtë rast duhet të lejohej gjyqtari E. B. të paraqiste rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit që e përjashtonte atë nga gjykimi.*

*Më ka rezultuar se kundër vendimit të mësipërm ka paraqitur ankesë pala R. Q.*

*Ndodhur në këtë situatë e gjithë dosja gjyqësore, pra: (1) dosja e themelit kërkesë penale; (2) dosja e gjyqtarit që ka vendosur përjashtimin; (3) dosja e gjyqtarit të gatshëm që ka vendosur lejimin e rekursit ndaj përjashtimit, janë nisur në Gjykatën e Apelit, mbi bazën e ankimit të palës R. Q. Në këto kushte, kam qenë në pamundësi për të proceduar me hedhjen në short të dosjes gjyqësore tek një gjyqtar tjetër dhe kam pritur që nga Gjykata e Apelit të merrej në shqyrtim ankimi i paraqitur. Rezulton se Gjykata e Apelit ka vendosur 'prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 23.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër', i cili i jepte të drejtë gjyqtarit E. B. të paraqiste ankim të drejtpërdrejtë dhe me këtë vendim është hapur rruga për zëvendësimin e këtij gjyqtari nga çështja dhe kam vendosur hedhjen në short të kësaj çështjeje.*

*Pra rezulton se pavarësisht se nga ana e gjyqtarit A. Y. është vendosur përjashtimi i gjyqtarit E. B. nga gjykimi i çështjes, ky vendim nuk mund të ishte i ekzekutueshëm për shkak se nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.6.2014, është pranuar që ndaj vendimit të përjashtimit mund të bëhet ankim i drejtpërdrejtë dhe, si rrjedhojë, vendimmarrja nuk ishte e formës së prerë, që lejonte kalimin në një moment tjetër procedural të rishortimit të çështjes.*

*Si rrjedhojë, vlerësoj se si gjyqtar nuk kam pasur asnjë vendimmarrje në këtë çështje, por si Kryetar i Gjykatës kam qenë i detyruar të zbatoj vendimmarrjet e marra nga gjyqtarët e tjerë, konkretisht vendimin nr. \*\*\*, datë 23.6.2014, i cili, duke lejuar ankimin e z. E. B., ka hequr mundësinë që vendimi i përjashtimit të këtij gjyqtari të ishte i ekzekutueshëm menjëherë nga ana e administratës gjyqësore.*

*Vlerësoj se nuk kam kryer absolutisht asnjë zvarritje të gjykimit. Në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës nuk kam pasur asnjë mundësi për të pasur vendimmarrje pranë çështjeve të gjyqtarëve të tjerë, madje në të vetmin rast kur kam çmuar se gjyqtari E. B. nuk legjitimohej të paraqiste ankim ndaj vendimit të përjashtimit të tij kam kaluar çështjen për vlerësim pranë gjyqtarit të gatshëm, sipas praktikës së Gjykatës në të tilla raste".*

**28.5** Trupi gjykues ka vlerësuar se pozicioni i subjektit të rivlerësimit në këtë dosje ka qenë në rolin e drejtuesit të institucionit. Kjo ankesë është trajtuar edhe në vijim tek rubrika “denoncimet” (denoncimi nr. 6).

## **DENONCIME**

**29.** Në Komision janë paraqitur 7 denoncime për subjektin Arbër Çela.

**29.1 Denoncim i shtetasit F. A.**, me objekt “Denoncim i disa subjekteve të rivlerësimit për shkelje ligji dhe moskryerje hetimi”. Sipas denoncuesit prokurorët nuk kryejnë hetime dhe tjetërsojnë fakte e prova. Në përmbajtjen e këtij denoncimi nuk parashtrohet ndonjë e dhënë apo pretendim në ngarkim të subjektit Arbër Çela. Denoncuesi nuk ka bashkëlidhur asnjë dokumentacion apo çështje konkrete të pretenduar.

Denoncimi nuk plotëson kriteret e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk përmban fakte dhe rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

**29.2 Denoncim i shtetasit P. A.**, me objekt “Denoncim i trupës gjyquese për paaftësi profesionale, subjekti i rivlerësimit ka qenë me cilësinë e anëtarit”. Denoncuesi ka vënë në dispozicion një kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 30.12.2014, me palë të pandehur shtetasin T. B., i akuzuar për kryerjen e veprave penale “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose kujdestari”, parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal dhe “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitura”, parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal. Denoncuesi pretendon se në përmbajtjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në ngarkim të shtetasit T. B. janë referuar emra të pandehurish dhe vepra penale që nuk kanë lidhje me këtë çështje.

Kjo çështje është gjykuar nga trupi gjykues, ku kryesues ka qenë gjyqtari T. S., dhe gjyqtari Arbër Çela ka qenë në cilësinë e anëtarit. Në përfundim të gjykimit trupa gjyquese ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit T. B. për kryerjen e veprave penale “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur” kryer më shumë se një herë dhe “marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari” kryer më shumë se një herë dhe në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal bashkimin e dënimeve dhe dënimin me 28 vite burgim.

Nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit të Gjykatës rezulton se në pjesën arsyetuese trupi gjykues i është referuar vrasjes së shtetasit F. P., me autor shtetasin M. J., si dhe veprës penale “shfrytëzim për prostitucion”, mbetur në tentativë, me palë dy shtetase të dëmtuara. Konstatohen pasaktësi (gabime materiale) në pjesën arsyetuese të vendimit, të pretenduara nga denoncuesi.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit shpjegon se: *“Konstatimi i Komisionit është i drejtë, por dua të sjell në vëmendje faktin se në çështjen konkrete unë kam qenë në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues. Sipas praktikës së Gjykatës, arsyetimi i dosjes kryhet nga kryesuesi apo gjyqtari të cilit i është caktuar me short çështja. Në rastin konkret nga ana e gjyqtarit kryesues më është dhënë vendimi të cilin e kam lexuar dhe nënshkruar, por për shkak të ngarkesës së madhe në punë nuk kam vënë re gabimet materiale në të.*

*Nga ana tjetër gabimet materiale të bëra nga kryesuesi nuk kanë cenuar të drejtat e pandehurit në gjykim. Vendimi është ankimuar për themelin e tij në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.4.2015, është vendosur: ‘Lënia në fuqi e vendimit nr. \*\*\*, datë 30.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër’. Në asnjë moment në arsyetimin e Gjykatës së Apelit nuk janë përmendur gabimet materiale të vendimit dhe, si rrjedhojë, në asnjë moment këto gabime nuk janë bërë shkak për cenim të të drejtave të palëve (bashkëngjitur si provë vendimi nr. \*\*\*, datë 14.4.2015, i Gjykatës së Apelit Shkodër)’.*



**29.3 Denoncim i shtetasit G. B.** (bashkim i 2 denoncimeve), me objekt “Denoncim i disa subjekteve të rivlerësimi për shkelje ligji dhe vendimmarrje të padrejtë, ndër të cilët edhe subjektin e rivlerësimit”. Denoncuesi pretendon se gjyqtari Arbër Çela dhe prokurori i çështjes gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor paraprak kanë favorizuar në mënyrë të kundërligjshme dhe abuzive pozitën e të pandehurit H. I. (autori i krimit më palë të dëmtuar denoncuesin), duke ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale nga “vrasje me dashje” në “plagosje e rëndë me dashje”.

Lidhur me këto të dhëna Komisioni kërkoi informacion dhe kopje dokumentacioni nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga verifikimi i akteve të vëna në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër<sup>33</sup> rezultojnë vendimi nr. \*\*\*, datë 22.12.2020, me palë kërkuese Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, viktimë shtetasi G. B. dhe palë të pandehur shtetasin H. I., me objekt “Dërgimi në gjyq të procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2020, në ngarkim të këtij shtetasi të akuzuar për kryerjen e veprave penale ‘plagosje e rëndë me dashje’ dhe ‘mbajtje e armëve në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente’”, gjykuar nga gjyqtari Arbër Çela, në cilësinë e gjyqtarit paraprak. Shqyrtimi në themel i kësaj çështjeje penale ka vijuar nga gjyqtari S. Sh., i cili, me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.6.2021, ka deklaruar fajtor të pandehurin H. I. për kryerjen e veprave penale “plagosje e rëndë me dashje” dhe “mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, si dhe në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal dhe nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij me 4 vjet e 8 muaj burgim. Ky vendim është apeluar nga i pandehuri H. I. dhe Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur mospranimin e ankimit.

Kërkesa e prokurorit për dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2020 është regjistruar në gjykatë në datën 11.11.2020 dhe në datën 12.11.2020 nga shorti elektronik është caktuar gjyqtar Arbër Çela, i cili ka planifikuar në datën 19.11.2020 seancën gjyqësore paraprake për t’u zhvilluar më 1.12.2020.

Gjatë shqyrtimit me seancë paraprake, gjyqtari Arbër Çela ka vlerësuar se në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale Prokuroria ka akuzuar të pandehurin për veprën penale “vrasje me dashje”, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, për të cilën nga ana e viktimës u ngritën pretendime, duke mos qenë dakord me qëndrimin e prokurorisë. Po ashtu gjatë seancës ka pasur edhe deklarime të prokurorit dhe në përfundim gjyqtari ka vendosur ndryshimin e cilësimit të veprës juridike, duke u shprehur se Prokuroria ka kryer një cilësim<sup>34</sup> jo të saktë dhe të gabuar të veprës penale si “vrasje me dashje”, pasi nga tërësia e akteve provuese i pandehuri H. I. ka konsumuar tërësisht veprën penale “plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal. Me këtë qëndrim të gjyqtarit ka rënë dakord edhe prokurori i çështjes, i cili pranoi qëndrimin e Gjykatës. Gjyqtari ka arsyetuar në vendim se duke qenë se nga ana e të pandehurit është kërkuar gjykim i shkurtuar, gjykata çmon se hetimet janë të plota dhe çështja duhet dërguar për gjykim në themel.

Në përfundim sa më sipër duket se gjyqtari Arbër Çela ka kryer vonesa procedurale në caktimin e datës së seancës paraprake. Ai ka bërë ndryshimin e kualifikimit të cilësimit të veprës sipas bindjes së tij, vendim ky i lënë në fuqi edhe nga gjyqtari që ka gjykuar themelin e çështjes.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

*Në lidhje me faktin e ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale: vlerësoj se kam zbatuar në mënyrë korrekte ligjin, duke u bazuar në provat e paraqitura nga palët. Po*

<sup>33</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.6.2022.

<sup>34</sup>Kodi i Procedurës Penale, neni 332/d, pika 3: “Kur gjatë seancës paraprake del se cilësimi juridik i faktit është i gabuar ose kur akuzat nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë, gjykata fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Në rast se prokurori nuk vepron, gjykata vendos t’i kthejë aktet. Ky vendim i njoftohet Drejtuesit të Prokurorisë”.

*ashtu rezulton se i njëjti cilësim i veprës penale është pranuar edhe nga gjyqtari i themelit dhe vendimi ka marrë formë të prerë.*

*Sjell në vëmendje faktin se mbi bazën e denoncimit të z. B., ILD-ja ka nisur procedurën verifikuese dhe me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 10.9.2021, ka vendosur arkivimin e kërkesës për shkak të mos konstatimit të asnjë shkeljeje disiplinore. Bashkëlidhur do ju vendos në dispozicion vendimin e ILD-së. Gjithashtu, kjo çështje është jashtë periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016. Duket se të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr. 6, datë 18.6.2020, ku ndër të tjera, thuhet se: ‘47.1. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të vendimit të Komisionit mbi faktet e shqyrtuara nga denoncimet, vëren se pretendimet e sipërcituara qëndrojnë pjesërisht, pasi: a. Vendimi i referuar në denoncimin e parë, nga znj. F. K. i përket vitit 2000, kohë kjo që nuk përfshihet në periudhën e rivlerësimit 2013 – 2016 dhe as në periudhën përjashtimore të parashikuar në nenin 41, pika 498 e ligjit nr. 84/2016 (1.1.2006)’”.*

**29.4 Denoncim i shtetasit I. M.** (bashkim i tri denoncimeve), me objekt “Denoncim i subjektit të rivlerësimit dhe i një prokuroreje për korrupsion dhe fshehje pasurie”. Referuar aktit të denoncimit rezulton se denoncuesi ka paraqitur në vitin 2013 kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër në ngarkim të shtetasve S. B. dhe A. B., me pretendimin se këta shtetas me anë të akteve të falsifikuara kanë përvetësuar truallin me sipërfaqe 1.800 m<sup>2</sup> në pronësi të familjes së tij, mbi të cilin është ndërtuar objekt banimi 5-katësh. Denoncuesi pretendon se gjyqtari Arbër Çela nuk hetoi dhe nuk shqyrtoi provat në dosje, por la në fuqi vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për pushimin e procedimit penal në ngarkim të shtetasit S. B. Sipas denoncuesit, gjyqtari dhe prokurorja e çështjes kanë kryer korrupsion, duke përfutur nga shtetasi S. B. shuma parash dhe apartament banimi të regjistruar në emër të të tjerëve, si shumica e gjyqtarëve.

Lidhur me këto të dhëna, Komisioni kërkoi informacion dhe dokumentacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga verifikimi i akteve të vëna në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër<sup>35</sup> rezulton vendimi nr. \*\*\*, datë 14.11.2013, me palë ankuese shtetasin I. M., kundër Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, person i tretë shtetasi S. B., me objekt “Kundërshtim të vendimit datë 29.7.2013, për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2013, të Prokurorisë së Rrethit Shkodër”. Gjyqtari Arbër Çela, në përfundim të gjykimit, ka vendosur për rrëzimin e kërkesës së ankuesit I. M.. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim shtetasi I. M. dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.4.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Shtetasi I. M. ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.7.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Nga verifikimi i bërë nga Komisioni lidhur me pretendimin e denoncuesit ka rezultuar se gjyqtari Arbër Çela, në aplikim të nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale<sup>36</sup>, ka analizuar veprimet e nevojshme hetimore të kryera nga Prokuroria në raport me vendimin e pushimit të procedimit penal, për shkak se vepra penale është parashkruar. Gjyqtari ka argumentuar se nga veprimet hetimore të kryera nga Prokuroria është evidentuar se të gjitha veprimet ligjore për kalimin e pronësisë dhe regjistrimin në regjistrat publikë janë kryer para vitit 2006. Sipas Prokurorisë edhe në rast se është falsifikuar ndonjë dokument dhe është përdorur për regjistrimin në vitin 2006 kanë kaluar mbi 7 vjet dhe ndjekja penale është parashkruar.

Në referim të nenit 186 të Kodit Penal për veprën penale “falsifikim i dokumenteve” parashikohet dënimi me burgim deri në 3 vjet. Në aplikim të germës “c” të nenit 66 të Kodit Penal parashikohet se nuk mund të bëhet ndjekja penale kur nga kryerja e veprës

<sup>35</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.6.2022.

<sup>36</sup>Neni 329: “Kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri. Gjykata, kur e gjen të drejtë ankimin e të dëmtuarit, vendos që hetimet të vazhdojnë, ndërsa pranon ankimin e të pandehurit ndryshon vendimin e pushimit me formulim më të favorshëm për të pandehurin. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit nga prokurori, i dëmtuari dhe i pandehuri”.

deri në marrjen e personit si të pandehur kanë kaluar pesë vjet për krime që parashikojnë dënim deri në 5 vjet burg ose gjobë. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga gjykata më e lartë.

Për sa i përket pretendimit të denoncuesit për pasuri të fshehur të gjyqtarit në qytetin e Shkodrës, ai nuk ka paraqitur të dhëna për verifikime të mëtejshme, ndaj Komisioni nuk ka marrë në konsideratë këtë *indicie*, pasi sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, nuk përmban fakte dhe rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me ndonjë nga kriteret e vlerësimit të subjektit rivlerësues.

**29.5 Denoncim i shtetasit F. D.**, në të cilin denoncuesi ankohet përkundrejt dy subjekteve që kanë gjykuar në trupa gjykuese në cilësinë e kryetarit, përkatësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër, të cilët, sipas tij, në vendimmarrjen që kanë marrë kanë kryer korrupsion, duke deklaruar të pafajshëm shtetasit E. D., D. D. etj. dhe duke dënuar dy punëtorët R. K. dhe V. Rr.

Lidhur me këto të dhëna Komisioni kërkoi informacion dhe kopje dokumentacioni nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga verifikimi i akteve të vëna në dispozicion nga kjo Gjykatë<sup>37</sup> rezulton se Prokuroria ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurve E. D., V. D., V. Rr., D. D., A. Gj. dhe R. K. për kryerjen e veprave penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, kryer në bashkëpunim dhe “kultivim i bimëve narkotike”, kryer në bashkëpunim.

Nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit nr. \*\*\*, datë 2.5.2017 të gjykatës së rrethit gjyqësor Shkodër, konstatohet se trupi gjykues nuk ka vlerësuar të gjitha provat e paraqitura nga prokurori në dosjen e hetimit si prova të paraqitura nga Prokuroria për fajësinë e të gjithë të pandehurve, si: (i) transkriptimet e përgjimeve ambientale dhe telefonike ndërmjet të pandehurve ku përmendet lënda narkotike e tharë dhe e kultivuar dhe ajo e gjetur në banesë nga policia; (ii) hyrje-daljet nga sistemi *TIMS* për shtetasin E. D., ku provohet se gjatë kohës së kultivimit dhe tharjes së bimës narkotike ka qenë në Shqipëri; (iii) procesverbalet e këqyrjes së tabulateve telefonike, ku evidentohen komunikime në periudhën e ngjarjes mes të pandehurve V. D., D. D., V. Rr., R. K. dhe E. D.

Duket se trupi gjykues, në vlerësimin e kryer dhe vendimmarrjen e tij, ka anashkaluar vlerësimin e provave të marra në fazat e hetimit paraprak nga Prokuroria, duke vepruar në gjykimin e kësaj çështjeje në kundërshtim me parashikimet ligjore të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, duke mos shqyrtuar në tërësi provat dhe duke çmuar vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre.

Në përfundim të sa më sipër, nga vlerësimi i çështjes në tërësinë e saj, duket se vendimi i gjykatës së shkallës së parë, dhënë nga trupi gjykues me kryesues gjyqtarin Arbër Çela, është dhënë duke deformuar rëndësinë e provave dhe lehtësimin e pozitës së tre prej të pandehurve. Gjatë procesit janë kryer vonesa procedurale në cenim të afatit të parashikuar nga legjislacioni në fuqi dhe të drejtës së palëve për një proces të rregullt ligjor.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit shpjegon se: *“Fillimisht dua të theksoj faktin se denoncimi në fjalë është dashakeq, nisur nga fakti se nga ana ime më herët denoncuesit F. D., me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.4.2014, i është caktuar masa e sigurimit ‘arresti në burg’, dyshuar për kryerjen e veprës penale ‘moskallëzim i krimi’, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.*

<sup>37</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.6.2022.

*Në lidhje me konstatimet e Komisionit, nuk jam dakord, pasi nuk rezulton në asnjë moment të kem favorizuar pozitën e të pandehurve, për arsytet e mëposhtme:*

*Në vendimin e zbardhur kam arsyetuar me detaje të gjitha provat e prokurorisë, duke i ballafaquar ato me ligjin, me praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë në raste të ngjashme dhe po ashtu me doktrinën juridike relevante. Në asnjë moment nuk kam anashkaluar asnjë provë pa analizuar në detaje. Vendimi është ankimuar nga ana e prokurorisë dhe nga ana e të pandehurve, ku Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.11.2017, ka rrëzuar si të pabazuar në ligj çdo pretendim të prokurorisë, duke e gjetur të drejtë vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Po ashtu rezulton se nga ana e trupit gjykues se jo vetëm nuk rezulton të jetë favorizuar asnjë i pandehur, por në të kundërt, Gjykata e Apelit ka pranuar ankimet e të pandehurve duke ndryshuar pjesërisht vendimin dhe lehtësuar edhe më shumë pozitat e tyre. Si rrjedhojë, pretendimi se nga ana ime janë lehtësuar pozitat e të pandehurve është i pambështetur.*

*Nga ana tjetër nuk qëndron pretendimi i Komisionit se ‘Në vlerësimin e kryer dhe vendimmarrjen e tij ka anashkaluar vlerësimin e provave të marra në faza e hetimit paraprak nga Prokuroria. Duket se trupa gjykuese ka vepruar në gjykimin e kësaj çështjeje në kundërshtim me parashikimet ligjore të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, duke mos shqyrtuar në tërësi provat dhe duke çmuar vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre’. Sjell në vëmendje faktin se neni 152 i Kodit të Procedurës Penale<sup>38</sup>, titulluar ‘Çmuarja e provave’, i përmendur nga Komisioni në këtë konstatim, bën fjalë pikërisht për interpretimin e provave apo fuqinë e tyre provuese. Ndërkohë që konstatimet që lidhen me mënyrën e vlerësimit të provave janë në tejkalim të kompetencës lëndore që kanë organet e rivlerësimit në drejtim të kontrollit e verifikimit të aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit.*

*Nga leximi i akteve të dosjes më rezulton se në analizë të të gjitha fakteve në asnjë moment nuk rezulton që nga ana ime të jenë kryer zvarritje të procesit apo shkelje të afateve procedurale e, si rrjedhojë, të jenë cenuar të drejtat e palëve në gjykim.*

*Këto provohen me: informacionin mbi çështjen me nr. sistemi \*\*\*, përfunduar me vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*) , datë 2.5.2017; RIV të çështjes me nr. sistemi \*\*\*, përfunduar me vendimin nr. \*\*\* (\*\*\*) , datë 2.5.2017; formimin e trupit gjykues datë 27.12.2016, të Kryetarit të Gjykatës”.*

**29.6 Denoncim i shtetas R. H.** (bashkim i dy denoncimeve), me objekt “Denoncim i subjektit të rivlerësimit dhe disa gjyqtarë të tjerë për vendimmarrje të padrejtë dhe korrupsion”. Denoncuesja pretendon se gjyqtari Arbër Çela ka zvarritur procesin gjyqësor, duke mbajtur dosjen administrative penale 9 muaj në sekretari pa e hedhur në short, për arsye se gjyqtari i përjashtuar E. B. paraqiti rekurs kundër vendimit që e përjashtoi.

Referuar aktit të denoncimit rezulton se shtetasi M. Q., i përfaqësuar nga bashkëshortja e tij R. Q., kanë qenë palë paditëse në procese gjyqësore të zhvilluara ndër vite në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt “Kundërshtimin e vendimit të pushimit të çështjes nr. \*\*\* të vitit 2011, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër”. Nga aktet e vëna në dispozicion nga denoncuesja rezulton se gjyqtari Arbër Çela ka gjykuar në datën 9.12.2014 çështjen me palë kërkuese shtetasin M. Q., me objekt “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2012, të Prokurorisë së Rrethit Shkodër”. Në përfundim të gjykimit gjyqtari Arbër Çela ka vendosur pushimin e gjykimit të kësaj çështjeje. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim shtetasi M. Q. në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila, në datën 30.4.2015, ka vendosur për prishjen e vendimit të shkallës së parë për shkak të shkeljeve të

<sup>38</sup>Neni 152 parashikon se: “Asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji. Gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj. 2. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet, përveçse kur këto janë të rëndësishme, të saktë dhe në përputhje me njëra-tjetrën. 3. Deklarimet e bëra nga i bashkëpandehuri në të njëjtën vepër penale ose nga personi i marrë si i pandehur në një procedim që lidhet me të, vlerësohen në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre”.

procedurave që janë lejuar nga gjyqtari gjatë gjykimit. Në vijim gjyqtari Arbër Çela ka marrë në shqyrtim në datën 12.2.2015 çështjen me palë kërkuese shtetasin M. Q. dhe objekt “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. \*\*\* të viti 2011, të Prokurorisë së Rrethit Shkodër”, për të cilën ka vendosur pushimin e gjykimit. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila, në datën 25.6.2015, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit procedural.

Duket se gjyqtari Arbër Çela ka shqyrtuar dhe gjykuar këtë çështje në kundërshtimin me përcaktimet e nenit 18 të Kodit të Procedurës Civile, duke vijuar me kryerjen e veprimeve procedurale, në kushtet kur kjo çështje duhet të ishte pezulluar.

Lidhur me vendimin e datës 12.2.2015, të gjyqtarit Arbër Çela, për pushimin e çështjes me palë kërkuese shtetasin M. Q. dhe objekt “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. \*\*\* të viti 2011, të Prokurorisë së Rrethit Shkodër”, konstatohet se gjyqtari duhet të vijonte me shqyrtimin e kërkesës edhe pa praninë e shtetasit M. Q. dhe në përfundim të vendoste sipas alternativave që lejon ligji procedural penal.

Duket se gjyqtari Arbër Çela ka pushuar këtë çështje në kundërshtim me përcaktimet e nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, duke mos iu përgjigjur objektit të kërimit si në pjesën arsyetuese, ashtu edhe në pjesën urdhëruese.

Vendimi i pushimit është i pabazuar, i pambështetur në asnjë dispozitë ligjore, pasi ligji procedural penal për ankimet ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nuk parashikon pushimin e gjykimit.

Duket se gjyqtari Arbër Çela në gjykimin e këtyre çështjeve ka vepruar në kundërshtim të ligjit procedural, duke cenuar dhe mohuar të drejtën e palëve për një proces të rregullt ligjor, parim i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit shpjegon se: *“Në rastin konkret vlerësoj se kam zbatuar me korrektësi legjislacionin procedural penal dhe më konkretisht nenin 18 të Kodit të Procedurës Penale, të cituar edhe nga Komisioni. Kështu, sipas nenit 18 të Kodit të Procedurës Penale, titulluar ‘Përrjashtimi i gjyqtarit’, përcaktohet se: ‘1. Palët mund të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit: (a) në rastet e parashikuara nga nenet 15, 16 dhe 17; (b) kur gjatë ushtrimit të funksioneve dhe para se të jetë dhënë vendimi ai ka shfaqur mendimin e tij mbi faktet ose rrethanat objekt procedimi. 2. Gjyqtari nuk mund të japë ose të marrë pjesë në dhënien e vendimit derisa të jepet vendimi që e deklaronte të papranueshme ose që e rrëzon kërkesën e përjashtimit’. Siç lexohet nga dispozita, qëllimi i ligjvënësimit nuk është në asnjë moment pezullimi i gjykimit me paraqitjen e një kërkesë për përjashtim, pasi një procedurë e tillë do të fuste në ngërç procesin sa herë që një palë paraqet një kërkesë të tillë. Përkundrazi, ligjvënësi shprehet se gjyqtari nuk mund të marrë pjesë në dhënien e vendimit deri në momentin që do të përcaktohet fati i kërkesës për përjashtim. Më tej, neni 22 i Kodit të Procedurës Penale, titulluar ‘Vendimi mbi kërkesën e përjashtimit’, në pikën 3 të tij parashikon se: ‘2. Gjykata mund të pezullojë përkohësisht çdo veprimtari procedurale ose ta kufizojë atë në kryerjen e veprimeve të ngutshme’. Pra ligji shprehet se gjykata mund (dhe jo duhet) të pezullojë veprimtarinë procedurale. Nga leximi i kësaj dispozite rezulton se pezullimi nuk është një efekt i menjëhershëm apo detyruar me paraqitjen e një kërkesë për përjashtim, por vlerësohet vetë nga gjykata nëse ka vend për pezullimin e procedurave apo jo.*

- i. *Ky qëndrim është mbajtur edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me anë të vendimit nr. \*\*\*, datë 15.5.2020, duke përcaktuar se: ‘Nga ana tjetër çështja e cila vihet në bisedim nga ky Kolegj, ka të bëjë me interpretimin e nenit 18/2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit: ‘Gjyqtari nuk mund të japë ose të marrë pjesë në dhënien e vendimit derisa të jepet vendimi që e deklaronte të papranueshme ose që*

rrëzon kërkesën e përjashtimit', bën fjalë vetëm për dhënien e vendimit përfundimtar. 21. Në këtë përfundim Kolegji, arrin dhe referuar nenit 23 të Kodit të Procedurës Penale sipas të cilit akti që pranon kërkesën e përjashtimit cakton nëse dhe në ç'pjesë kanë vlerë veprimet e kryera më parë nga gjyqtari. Në interpretimin 'a contrario' kur nuk pranohet kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit nuk mund të përbëjë shkak përjashtimi fakti i kryerjes së veprimeve procedurale nga gjykata. Pëzullimi përkohësisht i çdo veprimtarie nuk ka karakter detyrues për gjykatën sipas nenit 22/2 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se: 'Gjykata mund të pezullojë çdo veprimtari procedurale...'

- ii. Në rastin konkret rezulton se unë kam dalë me vendim përfundimtar në datën 9.12.2014, vetëm pasi ishte rrëzuar kërkesa për përjashtimin tim. Konkretisht, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, është vendosur: 'Rrëzimi i kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit Arbër Çela nga gjykimi i çështjes administrativo-penale nr. \*\*\*, datë 20.1.2014'. Sa më sipër, vlerësoj se kam zbatuar në mënyrë korrekte parashikimet ligjore për një situatë të tillë. Po ashtu, në kërkesën për përjashtim nga ana e Gjykatës është arsyetuar se: 'Nga gjykata (gjyqtari Arbër Çela) janë zbatuar me përpikëri rregullat procedurale gjatë gjykimit, gjyqtari ka lejuar kërkesin të bëjë kërkesat e tij gjatë gjykimit.
- iii. Në rastin konkret, jo vetëm nuk kam cenuar asnjë të drejtë të palës denoncuese, por në të kundërt bashkë me prokuroren, znj. D. H., jemi fyer dhe ofenduar nga pala, siç provohet edhe nga procesverbali gjyqësor. Pavarësisht këtij fakti kam zbatuar me korrektësi normat e etikës dhe rregullat procedurale penale. Pala kërkuese nuk është paraqitur në gjykim, pavarësisht dijenisë së saj për procesin gjyqësor dhe, si rrjedhojë, në asnjë moment nuk rezulton t'i jenë shkelur të drejtat procedurale. Për më tepër theksoj faktin se po t'i referohemi procesverbalit gjyqësor në periudhën e ndërmjetme nga paraqitja e kërkesës për përjashtim deri në marrjen e vendimit përfundimtar nuk është zhvilluar asnjë seancë gjyqësore efektive për shkak të ripërsëritjes së njoftimit për kërkesin dhe për shkak të mungesës së përsëritur të prokurores. Si rrjedhojë, edhe sikur për një moment të mendohej se nga ana ime është zbatuar keq ligji procedural në lidhje me mospezullimin e gjykimit, në asnjë moment palës nuk i ka ardhur asnjë pasojë, për sa kohë në asnjë moment nuk ka rezultuar e kryer ndonjë seancë (gjykimi) efektive.

Në përfundim kam bindjen se vendimmarrja ime për mospezullim të procesit është e drejtë dhe siç rezulton gjen mbështetje në nenet 18 dhe 22 të Kodit të Procedurës Penale dhe po ashtu është gjetur si interpretim i drejtë edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. \*\*\*, datë 15.5.2020.

Është i vërtetë konstatimi i Komisionit se për ankimet ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penale nuk parashikon pushimin e gjykimit, e njëjta situatë vlen edhe për ankimet ndaj vendimit të pushimit apo të gjitha kërkesat administrativo-penale, por nga ana e praktikës gjyqësore është interpretuar se këto lloj kërkesash lidhen ngushtësisht me vullnetin e palës iniciuese të gjykimit. Kështu, në vendimin nr. \*\*\*, datë 3.4.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera, shprehet: 'Në referim të nenit 112 të Kodit të Procedurës Penale, janë dy mënyrat me të cilat disponon gjykata, që janë vendim dhe urdhër. Edhe në rastin konkret, pa praninë e vetë të gjykuarit apo të një prokure për avokatin, në kushtet që gjykata duhej të jepte një vendim, mënyra e vetme e disponimit ishte dhënia e një vendimi jopërfundimtar, siç është vendimi i pushimit të gjykimit të çështjes, pasi mungonte vullneti i të gjykuarit për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit. Në të njëjtën mënyrë procedon gjykata edhe kur kërkuesi lë gjykimin dhe nuk paraqitet më në seanca gjyqësore. Edhe në këtë rast, në mungesë të një dispozite të shprehur ligjore, gjykata vendos pushimin e gjykimit të çështjes, meqenëse pala nuk ka më interes. Në këtë kuptim, ky kolegji çmon se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është dhënë në zbatim të drejtë të dispozitave procedurale.

*Gjykata e shkallës së parë, në rastin objekt shqyrtimi, ka konstatuar se ka një vakum ligjor në lidhje me parashikimin e mosparaqitjes së kërkesit apo të mbrojtësit nëse gjykata pavarësisht kësaj vazhdon marrjen në shqyrtim të kërkesës apo duhet të pushojë çështjen... Kolegji Penal vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vendosur pushimin e shqyrtimit të kërkesës, duke i bërë një interpretim të zgjeruar sipas parimeve të gjykimit penal. Kodi i Procedurës Penale përcakton rregullat procedurale që ndiqen në një proces penal, duke përcaktuar palët që thirren në proces dhe pasojat e mosparaqitjes. Përveç formës së gjykimit të një akuze që përbën formën klasike të gjykimit penal, në Kod parashikohen edhe disa gjykime të posaçme të iniciuara nga palët lidhur me kërkesa që lidhen me procesin penal në tërësi. Një nga këto forma është edhe kërkesa për rivendosje në afat’.*

*Gjithashtu, në vendimin nr. \*\*\*, datë 16.1.2013, të Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë, theksohet se: ‘Gjykata e shkallës së parë ka disponuar me mospranim të ankimit, ndërkohë që duhet të dispononte me pushim të gjykimit. Mospranimi i ankimit ka të bëjë me shqyrtimin në themel të pretendimeve të ankuesit e lidhur detyrimisht me një vendimmarrje të Gjykatës, për sa i përket ligjshmërisë së pushimit të procedimit penal nga ana e prokurorit. Ndërkohë vendimi i pushimit të gjykimit për mosparaqitje të subjektit ankues ndërpret vetëm shqyrtimin gjyqësor të ankimit pa i vlerësuar në thelb shkaqet e ngritura nga ankuesi për të cilat kundërshton vendimin e prokurorit’. Në këtë vendim përcaktohet qartësisht forma e disponimit të gjykatës së shkallës së parë, kur kërkesa penale nuk shqyrtohet në themel, edhe pse nuk ka një parashikim eksplisit në ligj.*

*Sa më sipër, vlerësoj se vendimmarrja ime ka qenë në përputhje me rregullat procedurale penale, praktikën e Gjykatës së Lartë dhe praktikën e përditshme gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe gjykatave të tjera të vendit. Në asnjë moment nuk rezulton se janë cenuar dhe mohuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt ligjor, parim i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, për sa kohë kjo e fundit vetë ka humbur interesin për çështjen, duke mos u paraqitur në gjykim”.*

**29.7 Denoncim i shtetasit N. K.**, në të cilin denoncuesi pretendon se procedimi penal i regjistruar nga Prokuroria në ngarkim të tij për kryerjen e veprës penale “falsifikim kompjuterik” është pa asnjë bazë ligjore dhe gjyqtari Arbër Çela në gjykimin e kësaj çështjeje e dënoi padrejtësisht e pa asnjë fakt. Në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është aksesuar vendimi nr. \*\*\*, datë 16.2.2016, me palë kërkuese Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, të pandehur shtetasi N. K., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “falsifikim kompjuterik” dhe shtetasit M. N., K. F., A. M., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “deklaratë të rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore”. Nga përmbajtja e vendimit rezulton se kjo çështje gjyqësore është gjykuar në trupë gjykuese ku kryesues ka qenë gjyqtari Arbër Çela. Në përfundim të gjykimit, trupi gjykues ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit N. K., për kryerjen e veprës penale “falsifikim kompjuterik” dhe dënimin e tij me 4 vjet e 6 muaj burgim. Njëkohësisht trupa gjykuese në ngarkim të këtij të pandehuri ka aplikuar edhe nenin 35 të Kodit Penal, duke i hequr të drejtën për të ushtruar funksione publike për një periudhë 5-vjeçare. Për të pandehurit M. N., K. F. dhe A. M. trupi gjykues ka vendosur deklarinimin fajtor për kryerjen e veprës penale “deklaratë të rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore” dhe dënimin e tij me 200.000 (dyqind mijë) lekë gjobë.

Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.5.2018, ka prishur vendimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë, duke i kthyer aktet për rigjykim me një trupë tjetër gjykuese.

Në përfundim, nga vlerësimi i akteve duket se vendimmarrja e trupës gjyqesore me kryesues gjyqtarin Arbër Çela është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural penal, duke cenuar të drejtën e palës për një proces të rregullt ligjor.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit shpjegon: *“Fillimisht shpreh mendimin se nga ana e Komisionit nuk duhet të ishte administruar denoncimi i z. N. K. për shkak të gjuhës fyese të papranueshme të përdorur në denoncim nga ky shtetas ndaj meje personalisht, por edhe ndaj figurës së një gjyqtari të Republikës. Vetë denoncimi përbën provë të një veprë penale të kryer ndaj gjyqtarit.*

*Në arsyetim të pretendimeve të ngritura nga Komisioni shpjegoj se në këtë çështje penale z. N. K. akuzohej nga ana e prokurorisë se në detyrën e tij si punonjës pranë pikës së kalimit kufitar Muriqan kryente regjistrime fiktive në sistemin TIMS të automjeteve me qëllim që këto të fundit të shmangnin pagimin e penaliteteve apo detyrimeve doganore për shkak të tejkalimit të afatit të qëndrimit në vendin tonë. Në proces u administruan si provë dëshmitë e personave të pyetur para Gjykatës, por edhe deklaratimet e kryera në hetimet paraprake në rastet e parashikuara nga ligji. U morën si provë përgjigjet e autoriteteve malazeze në lidhje me regjistrimet në sistemin e tyre të përpunimit të të dhënave kufitare, po ashtu u administruan si provë qelizat telefonike për disa shtetas që sipas regjistrimeve të kryera nga i pandehuri duhet të figuronin jashtë shtetit.*

*Nuk qëndron konstatimi i Komisionit se: ‘Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është i paarsyetuar, në kundërshtim me parimet procedurale penale të parashikuara në nenet 112/3, 382 dhe 383 të Kodit të Procedurës Penale’.*

*Në lidhje me këtë pikë shprehem se:*

- i. Ky vendim është dhënë me trup gjyqësor të përbërë edhe nga gjyqtarët E. B. dhe T. S., ku të tre gjyqtarët kemi qenë unanim në çdo vendimmarrje të marrë gjatë procesit.*
- ii. Vendimi gjyqësor në rastin konkret është i arsyetuar në mënyrë të plotë, ku janë evidentuar të gjitha rastet ku është provuar se i pandehuri N. K. ka kryer veprën penale objekt akuze ‘falsifikim kompjuterik’ dhe po ashtu janë rrëzuar si të paprovuara rastet e tjera të pretenduara nga ana e prokurorisë.*
- iii. Vendimi gjyqësor është 18 faqe, ku janë marrë me radhë të gjitha rastet e pretenduara nga ana e prokurorisë, duke u ballafaquar me provat e administruara në gjykim. Po ashtu në çdo rast është arsyetuar përse administrohen provat e mbledhura gjatë hetimeve paraprake dhe njëkohësisht lidhja e tyre me faktin penal. Janë arsyetuar njëkohësisht edhe elementet e veprave penale, objekt akuze.*

*Nuk ka asnjë pengesë ligjore që nga ana e palëve në gjykim t’i kërkohet Gjykatës të përdoren deklaratimet e dhëna nga personat që kanë dijeni për veprën penale para policisë gjyqësore në rastet kur: (a) dëshmitari nuk arrihet të gjendet dot apo ka vdekur; (b) për të kundërshtuar tërësisht ose pjesërisht përmbajtjen e dëshmisë ose kur dëshmitari refuzon të dëshmojë. Kjo parashikohet qartësisht në nenin 362 të Kodit të Procedurës Penale, titulluar ‘kundërshtimi i dëshmisë’<sup>39</sup>.*

*Në vendim trupi gjyqësor ka arsyetuar qartë rastet kur janë administruar deklaratimet e kryera gjatë hetimeve paraprake. Në ato raste kur i jemi referuar deklaratimeve të dhëna*

<sup>39</sup>Neni 362 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: *“Për të kundërshtuar, tërësisht ose pjesërisht, përmbajtjen e dëshmisë ose kur refuzon të dëshmojë, palët mund të përdorin thëniet e bëra më parë nga dëshmitari para prokurorit ose policisë gjyqësore dhe që ndodhen në fashikullin e prokurorit, por vetëm pasi dëshmitari ka deponuar mbi faktet dhe rrethanat që kundërshtohen. 2. Këto thënie nuk përbëjnë provë në vetvete për faktet që pohohen në to, por ato mund të vlerësohen nga gjykata për të përcaktuar besueshmërinë e personit të pyetur dhe përfshihen në fashikullin e shqyrtimit gjyqësor. 3. Deklarimet e dhëna para prokurorit ose policisë gjyqësore mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre. 4. Deklarimet e mëparshme, të përfshira në fashikullin e gjyqimit, sipas pikës 2 të këtij neni, çohen si prova edhe kur rezultojnë se dëshmitari qoftë edhe gjatë pyetjes në seancë i nënshtrohet dhunës, katosjes, premtimit për t’i dhënë para ose përfitime të tjera, me qëllim që të mos dëshmojë ose të bëjë dëshmi të rreme, si dhe kur rezultojnë rrethanat të tjera që kanë dëmtuar sinqeritetin e përgjigjeve të tij”.*



në hetimet paraprake kemi arsyetuar qartë arsyen dhe rezultatin e përfutuar nga ballafaqimi i provave, duke dhënë arsyet konkrete përse një deklaram është i besueshëm apo jo apo përse vetë dëshmitari shfaq besueshmëri apo jo. Kështu, dëshmia e dy dëshmitarëve të pyetur në gjykim se regjistrimet e kryera nga i pandehuri në cilësinë e punonjësit të pikës së kalimit kufitar ishin të rregullta, pasi ata kishin kaluar realisht nga kufiri në Muriqan, duke ardhur nga Italia nëpërmjet rrugës tokësore (Kroaci etj.) u vunë në dyshim nga gjykata: (a) për shkak të mungesës së gjurmëve të regjistrimit të këtyre shtetasve në dy pikat e kalimit kufitar të Republikës së Malit të Zi (pika hyrëse me Kroacinë dhe dalje me Shqipërinë); (b) gjykata vlerësoi edhe interesin e dëshmitarëve për të mos pranuar në gjykim se hyrjet e automjeteve të tyre ishin fiktive (kjo mund të sillte përgjegjësi dhe për ta); si dhe (c) deklaramit të ndryshëm dhënë prej këtyre dëshmitarëve në hetimet paraprake.

Në përmbledhje vlerësoj se procedura e zbatuar nga ana e trupit gjykues ku kam qenë pjesë ka qenë korrekte, ku janë ndjekur me përpikëri të gjitha përcaktimet që parashikon Ligji Procedural Penal. Në thelb konstatimet në lidhje me faktin nëse provohet apo jo fajësia e të pandehurit, duke u bazuar në ato prova që janë mbledhur, lidhet me vlerësimin e fuqisë provuese të provave, vlerësim ky që siç kam arsyetuar edhe në rastet e tjetra të paraqitura më lart, janë jashtë kompetencës së kontrollit të organeve të rivlerësimit, kjo referuar edhe praktikës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Në rastin konkret vlerësoj se procedura e ndjekur është në zbatim korrekt të ligjit.

Në arsyetimin e vendimit si trup gjykues jemi shprehur se fakti i regjistrimit fiktiv të automjeteve në sistemin TIMS nga ana e të pandehurit rezultoi e provuar dhe nga administrimi i letërporosisë të marrë nga autoritetet e Republikës së Malit të Zi, të cilat kanë konfirmuar faktin se automjetet në fjalë të cilat vinin nga vendet e BE-së nuk rezultojnë të regjistruara as në pikën kufitare me Shqipërinë (Sukobinë) as në pikat e hyrjes me Kroacinë apo Serbinë. Po ashtu, këto prova u mbështetën dhe nga administrimi i qelizave telefonike të disa subjekteve të regjistruara, ku rezultonte se ata nuk ishin larguar nga Republika e Shqipërisë. Si rrjedhojë, si trup gjykues kemi konkluduar se mospërputhja midis ekzistencës së regjistrimeve të automjeteve në sistemin TIMS në Republikën e Shqipërisë dhe mungesës së tyre në sistemin TIMS në R. M. ishte rrjedhojë e ndërhyrjeve të falsifikuese të të pandehurit si punonjës i pikës së kalimit kufitar. Si rrjedhojë, bindja e trupit gjykues në lidhje me fajësinë e të pandehurve rezultoi në mënyrë të plotë nga ndërthurja e disa provave të cilat konfirmonin njëra-tjetrën.

Vlerësoj se vendimi i dhënë nga trupi gjykues në çështjen penale në ngarkim të të pandehurit N. K. është dhënë në zbatim të të gjitha të normave procedurale dhe materiale dhe në asnjë moment nuk i janë cenuar të drejtat. Të gjitha provat në gjykim janë administruar sipas procedurës që parashikon ligji dhe jo vetëm kaq, por janë administruar edhe me pëlqimin e mbrojtësit të të pandehurit, siç rezultoi qartazi nga administrimi i procesverbalit gjyqësor”.

**29.8** Nga investigimi në internet, Komisioni është vënë në dijeni mbi të dhëna të marra nga portalet mediatike, sipas së cilës i pandehuri K. Sh., nën akuzë për vrasje, ka përfutuar nga gjykata të drejtën e gjykimit të shkurtuar. Nga këto të dhëna rezultoi se trupi gjykues në këtë çështje kryesohej nga gjyqtari Arbër Çela. Lidhur me këto të dhëna Komisioni kërkoi informacion dhe dokumentacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Nga shqyrtimi i akteve të vëna në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër<sup>40</sup> rezultoi vendimi nr. \*\*\*, datë 7.3.2019, me palë kërkuese Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Shkodër, i pandehur shtetasi K. Sh., i akuzuar për

<sup>40</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.6.2022.

kryerjen e veprës penale “vrasje me paramendim”. Prokuroria ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit dhe dënimin e tij me 25 vjet heqje lirie.

Në përfundim të gjykimit, trupi gjykues, e kryesuar nga gjyqtari Arbër Çela, ka vendosur deklarinimin fajtor të këtij të pandehuri për veprën penale “vrasje me dashje” dhe dënimin e tij me 18 vjet heqje lirie, duke aplikuar nenin 406/1 të Kodit të Procedurës Civile i ulet 1/3 e dënimit, duke u dënuar me 12 vjet heqje lirie. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankimi dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.7.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

Subjekti i rivlerësimit shpjegon se: *“Në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.3.2019, me palë kërkuese Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Shkodër, i pandehur shtetasi K. Sh., i akuzuar për kryerjen e veprës penale ‘vrasje me paramendim’, dënuar për kryerjen e veprës penale ‘vrasje me dashje’, që parashikohet nga neni 76 i Kodit Penal me 18 vjet burgim.*

*Së pari, në çështjen konkrete nga ana e trupit gjykues kemi vlerësuar për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga ‘vrasje me paramendim’ në ‘vrasje me dashje’. Në arsyetimin e vendimit trupi gjykues ka cilësuar qartë të gjitha faktet që çojnë në ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, duke vendosur dhe referencë vendime të Gjykatës së Lartë (vendimin nr. \*\*\*, datë 8.2.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).*

*Rezulton se kundër këtij vendimi është paraqitur ankimi dhe Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.7.2019, lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Gjykata e Apelit ka gjetur të drejta të gjitha konkluzionet e nxjerra nga gjykimi në shkallë të parë. Nuk është gjetur asnjë shkelje procedurale në vendimmarrje.*

*Vlerësoj se nga trupi gjykues në të cilin unë kam qenë anëtar janë respektuar të gjitha dispozitat materiale dhe procedurale për çështjen në gjykim dhe është dhënë një vendim i bazuar në ligj e në prova.*

*Nga ana tjetër sjell në vëmendje faktin se kjo çështje është jashtë periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016. Duket se të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji i Posaçëm i Apelit me vendimin nr. 6, datë 18.6.2020, ku, ndër të tjera, thuhet se: ‘47.1. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të vendimit të Komisionit mbi faktet e shqyrtuara nga denoncimet, vëren se pretendimet e sipërcituara qëndrojnë pjesërisht, pasi: a. Vendimi i referuar në denoncimin e parë, nga znj. F. K., i përket vitit 2000, kohë kjo që nuk përfshihet në periudhën e rivlerësimit 2013 – 2016 dhe as në periudhën përjashtimore të parashikuar në nenin 41, pika 498 e ligjit nr. 84/2016 (1.1.2006)’”.*

**30.** Në vlerësim të konstatimeve mbi çështjet e trajtuara në kuadër të denoncimeve dhe një çështjeje të trajtuar si ankesë e vitit 2014, verifikuar për zvarritje gjykimi për gjyqtarin Arbër Çela, nga e cila rezultoi se përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore e sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 17.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezulton se ankesa nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2014, me ankues R. Q., është dërguar për trajtim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, trupi gjykues çmon se për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale rezultuan disa problematika që lidhen kryesisht me gjykimin e çështjeve të shqyrtuara nga gjyqtari apo trupi gjykues të cilat në vetvete përbëjnë objekt ankimi në gjykatat më të larta, e për të cilat Komisioni nuk mund të gjykojë lidhur me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Elementet e konstatuara gjatë hetimit të vlerësuar edhe në raport me shpjegimet dhe provat e vëna në dispozicionin nga subjekti i rivlerësimit në vijim të rezultateve të hetimit, nuk konsiderohen për nga pesha

e rëndësisë së tyre dhe pasojave që ato kanë sjellë, se mund të përcaktojnë vlerësimin e subjektit të rivlerësimit me mangësi në aspektin e indikatorit të aftësive profesionale sipas parashikimit të nenit 72-74 të ligjit nr. 96/2016, e nuk janë të tilla që meritojnë të ngrihen në nivelin e një sjelljeje të subjektit që cenon besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

**31.** Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, mbështetur në tërësinë e konkluzioneve të mësipërme dhe në legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues, nga një vlerësim objektiv dhe proporcional, vlerëson si vijon:

**i. Lidhur me kontrollin e vlerësimit të pasurisë,** trupi gjykues vlerëson se në analizën që i bën situatës faktike për llogari të procesit të rivlerësimit: kualifikimin ligjor të shtetases E. Zh., si bashkinvestitore në pasurinë apartament me sipërfaqe 91.91 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, blerë me Kontratë Porosie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.5.2013, Mundësitë financiare të shtetasit F.H., për huadhënien, e cila është zëvendësuar në vinim brenda vitit kalenderarik me kredinë bankare, mbajtur në konsideratë edhe trajtimi ligjor prej Kolegjit në raste të ngjashme<sup>41</sup>, vlerëson se, pasuria e subjektit të rivlerësimit Arbër Çela është krijuar në mënyrë të ligjshme dhe nuk ka mungesë burimesh financiare të ligjshme.

Në këto kushte, trupi gjykues e gjen këtë pasuri në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 84/2016, të besueshme e me burime financiare të ligjshme.

Konkluzioni i Komisionit në lidhje me këtë kriter është pasojë e analizimit në mënyrë të drejtë e të gjithanshme të të gjitha fakteve e provave që kanë rezultuar nga hetimi administrativ dhe i mbështetur në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore që rregullojnë kontrollin dhe vlerësimin e këtij kriteri.

Në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se subjekti përmbush nivelin e kërkuar të provueshmërisë së parashikuar nga neni 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe se ka arritur nivel të besueshëm në kriterit e kontrollit të pasurisë.

**ii. Lidhur me kontrollin e kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale,** trupi gjykues, pasi analizoi të gjitha gjetjet e paraqitura në rezultatet e hetimit, i analizoi në raport me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, gjatë prapësimeve të tij dhe atyre në seancën dëgjimore publike, arriti në konkluzionin se disa prej gjetjeve përfaqësojnë vlerësime e qëndrime në kapërcim të objektit të organeve të rivlerësimit lidhur me kontrollin e këtij kriteri, përpos gjetjeve që u konstatuan të pambështetura në ligj dhe fakte, sipas vlerësimit të trupit gjykues. Disa nga gjetjet e konstatuara janë të tilla që nuk mjaftonin për të kualifikuar aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit si nën nivelin minimal kualifikues, për pasojë, në analizë të të gjitha rrethanave të çështjes dhe kuadrit ligjor në fuqi, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit arrin nivelin minimal kualifikues në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale për efekt të këtij procesi, në kuptim të zbatimit të nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

**iii. Lidhur me vlerësimin për cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë,** sa i përket çështjeve të trajtuara në kreun B, “kontrolli i figurës”, trupi gjykues, nga një vlerësim i thellë i situatës, vlerësuar sipas kriterëve të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, ku vlerësuesi duhet të çmojë aftësitë e gjyqtarit pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet, çmon se në gjetjet e rezultateve të hetimit, në raport me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij, problematikat e hasura janë çështje gjyqësore që duhen zgjidhur nga gjykatat më të larta, duke mos cenuar lirinë dhe të drejtat e gjyqtarit në vendimmarrje.

<sup>41</sup>Shihni vendimin (JR) nr. 14, datë 15.6.2021 dhe vendimin nr. 38, datë 24.10.2022, të Kolegjit.

Trupi gjykues mban në vëmendje edhe qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj nr.17/2004, ndër të tjera, ka arsyetuar se: “... duke vlerësuar si shkak për shkarkim nga detyra të gjyqtarit mënyrën e gabuar të zbatimit të dispozitave materiale e procedurale për çështje konkrete në gjykim, jo vetëm ushtron attribute që nuk i përkasin, por ndërhyjnë drejtpërsëdrejti në objektivitetin dhe pavarësinë e gjykatës. Gjykata Kushtetuese thekson se gjyqtari nuk mund të shkarkohet nga detyra për mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, për sa kohë që nga rrethanat objektive dhe subjektive nuk rezulton se veprimet e tij mund të kenë qenë të qëllimshme dhe në kundërshtim të hapët dhe flagrant me ligjin apo me praktikatat unifikuese të gjykatave më të larta”.

Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se nuk ka vend për aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi në bindjen e tij të brendshme ato janë çështje që kanë të bëjnë me zgjidhjen e themelit të çështjes e që duhen trajtuar në shkallët më të larta të gjyqimit. Në këtë qëndrim trupi gjykues ka mbajtur në vëmendje edhe qëndrimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit në vendimin nr.28, datë 23.10.2020, juridiksion rivlerësimi, subjekti F.V.

**32.** Në përfundim, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues i Komisionit çmon se subjekti i rivlerësimit plotëson në mënyrë kumulative të tria kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përfshirë edhe vlerësimin për kontrollin e figurës dhe, në zbatim të kësaj dispozite, duhet të konfirmohet në detyrë.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, në germën “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, një nivel kualifikues të aftësive profesionale, pasi ka kryer në mënyrë proporcionale edhe vlerësimin tërësor në kuptim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Arbër Çela, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 7.12.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Kryesues**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Relatore**

**Genta Tafa (BUNGO)**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Jonida Vrana*